

REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E KAÇANIKUT

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E KAÇANIKUT 2026-2030

Korrik, 2026



KOMUNA E KAÇANIKUT

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E KAÇANIKUT 2026-2030



Korrik, 2026

Përgatitja e këtij dokumenti është bërë nga ALBO GROUP në partneritet dhe financuar nga Komuna e Kaçanikut

Autoriteti kontraktues: Komuna e Kaçanikut

Hartoi: ALBO GROUP në bashkëpunim me Komunën e Kaçanikut

PËRMBAJTJA

Lista e tabelave.....	VIII
Lista e grafikëve.....	IX
Lista e figurave.....	X
Lista e shkurtesave.....	XI
<i>Fjalja hyrëse e kryetarit të komunës</i>	13
<i>Përmbledhje ekzekutive</i>	14
1. Hyrje.....	15
2. Metodologjia.....	17
3. Vizioni, misioni dhe vlerat kyçe.....	20
4. Analiza e gjendjes aktuale dhe sfidat.....	22
Historik i shkurtër i komunës.....	22
Pozita dhe veçoritë gjeografike.....	23
Popullsia.....	25
Vendbanimet.....	29
Migrimi.....	33
Arsimi.....	34
Shëndetësia.....	37
Mirëqenia sociale.....	39
Tregu i punës.....	40
Shërbimet administrative.....	41
Infrastruktura.....	41
Telekomunikacioni.....	44
Rrjeti energjetik.....	44
Ndriçimi publik.....	45
Furnizimi me ujë.....	45
Kanalizimi.....	46
Mbeturinat.....	46
Kultura.....	47
Profili ekonomik i komunës së Kaçanikut.....	52
Krahasimi me vendet/komunat tjera.....	59
5. Analiza SWOT.....	60

6. Qëllimet dhe objektivat për zhvillim ekonomik.....	65
Qëllimet strategjike dhe objektivat specifike.....	65
7. Monitorimi dhe raportimi.....	79
8. Ndikimi buxhetor.....	80
Buxheti komunal.....	80
Vlerësimi buxhetor.....	84

<i>Shtojca 1 - Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.....</i>	<i>85</i>
--	-----------

<i>Shtojca 2 - Struktura organizative e komunës së Kaçanikut.....</i>	<i>108</i>
---	------------

Lista e tabelave

Tabela 1. Popullsia e komunës së Kaçanikut sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare.....	31
Tabela 2. Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Kaçanikut	32
Tabela 3a. Migrimi kombëtar në komunën e Kaçanikut, periudha 2021-2023.....	34
Tabela 3b. Migrimi ndërkombëtar në komunën e Kaçanikut, periudha 2021-2023	34
Tabela 4. Rangimi i grupeve kryesore të shkaqeve të vdekjes në komunën e Kaçanikut, 2020-2021.....	39
Tabela 5. Numri i të punësuarve në komunës së Kaçanikut, sipas drejtorive.....	41
Tabela 6. Vendbanimet sipas mënyrës së furnizimit me ujë.....	45
Tabela 7. Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2025), trashëgimia arkitekturore.....	48
Tabela 8. Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2025), trashëgimia arkeologjike.....	48
Tabela 9. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe shuara sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike, 2022-2023 në komunën e Kaçanikut	54
Tabela 10. Burimet e financimit në komunën e Kaçanikut (€), periudha 2026-2028.....	81
Tabela 11. Planifikimi i të hyrave vetanake në komunën e Kaçanikut (€), 2026-2028.....	82
Tabela 12. Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Kaçanikut (€), vlerësim për periudhën 2026-2028.....	83

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Popullsia në komunën e Kaçanikut sipas regjistrimeve, periudha 1948-2024.....	25
Grafiku 2. Shtimi natyror në komunën e Kaçanikut, periudha 2021-2023.....	26
Grafiku 3. Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Kaçanikut.....	27
Grafiku 4. Struktura etnike e popullsisë në komunën e Kaçanikut.....	27
Grafiku 5. Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Kaçanikut.....	28
Grafiku 6. Struktura moshore e popullsisë në komunën e Kaçanikut.....	29
Grafiku 7. Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Kaçanikut.....	32
Grafiku 8. Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948- 2024.....	33
Grafiku 9. Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare në komunën e Kaçanikut, 2019-2024.....	36
Grafiku 10. Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2022-2023.....	38
Grafiku 11. Të infektuarit me COVID-19 në komunën e Kaçanikut, 2020-2023.....	38
Grafiku 12. Statistikat e tregut të punës, 2024, në Republikën e Kosovës.....	40
Grafiku 13. Rrjeta e rrugëve në komunën e Kaçanikut.....	43
Grafiku 14. Struktura e përgjithshme e tokës në komunën e Kaçanikut.....	55
Grafiku 15. Sipërfaqja e tokës bujqësore në komunën e Kaçanikut.....	55
Grafiku 16. Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Kaçanikut (%), periudha 2023- 2028.....	81
Grafiku 17 Struktura mesatare e shpenzimeve në komunën e Kaçanikut (%), vlerësim për periudhën 2026-2028.....	84

Lista e figurave

Figura 1. Metodologjia e punës.....	18
Figura 2. Vlerat kyçe të komunës së Kaçanikut.....	21
Figura 3. Pozita gjeografike e komunës së Kaçanikut	23
Figura 4. Pamje e lumit Nerodime.....	30
Figura 5. Xhamia e Koxha Sinan Pashës.....	49
Figura 6. Kalaja e Llanishtës.....	50

Lista e shkurtesave

AMF	Ambulanca të Mjekësisë Familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
Ha	Hektarë
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KEDS	Kosovo Electricity Distribution and Supply Company
km	Kilometër
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
kv	Kilovat
m	Metër
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit – Asociimit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
QKMF	Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendër e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
QSHQ	Qendra për Shërbim me Qytetarë
SWOT	<i>Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats</i>
SZHEL	Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
SHFMU	Shkolla fillore të mesme të ulëta
SHML	Shkolla të mesme të larta
TIK	Teknologji informative dhe komunikim
TM	Tremujor

FJALIA HYRËSE NGA KRYETARI I KOMUNËS

Plani Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2030 është një udhërrëfyes themelor për zhvillimin ekonomik të Komunës së Kaçanikut në katër vitet e ardhshme.

Ky dokument paraqet vizionin, misionin dhe objektivat strategjike të komunës, duke ofruar një bazë solide për planifikim të informuar dhe vendimmarrje efektive, të mbështetur në analiza të të dhënave reale dhe potencialeve lokale.

Ky plan është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, ku administrata komunale, ekspertët e fushës, shoqëria civile dhe bizneset kontribuan për të krijuar një vizion të qartë dhe të qëndrueshëm për zhvillim ekonomik, inovacion dhe investime lokale.

Zbatimi i këtij dokumenti synon të rrisë punësimin, të përmirësojë mundësitë për zhvillim ekonomik lokal dhe të avancojë mirëqenien e qytetarëve tanë, duke promovuar përdorimin efikas të burimeve dhe ruajtjen e vlerave kulturore dhe natyrore të komunës.

Shpreh mirënjohjen time të sinqertë për të gjithë kontribuesit, të cilët e bënë të mundur hartimin e këtij plani strategjik, i cili do të shërbejë si udhërrëfyes i qartë për politikën zhvillimore të Komunës së Kaçanikut dhe si themel për një të ardhme të qëndrueshme për komunitetin tonë.



Singerisht,

Sabedin Vishi, Kryetar

Komuna e Kaçanikut

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në epokën e transformimeve të shpejta ekonomike dhe sociale, komuna e Kaçanikut ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një ekonomie lokale të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt zhvillimit afatgjatë. Ky plan strategjik është hartuar si një platformë veprimi për të adresuar sfidat aktuale dhe për të shfrytëzuar potencialet e pashfrytëzuara të komunës, duke vendosur qytetarin në qendër të politikave zhvillimore.

Kaçaniku përballet me një sërë sfidash që kërkojnë zgjidhje të menduara dhe të koordinuara: nevoja për rritjen e kapaciteteve të sektorit privat, përmirësimi i infrastrukturës publike, mbrojtja e mjedisit dhe përforcimi i shërbimeve sociale. Për t'u përballur me këto sfida, ky dokument ofron një qasje të strukturuar dhe të integruar, duke promovuar partneritetin ndërmjet institucioneve publike, biznesit lokal dhe komunitetit.

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal për periudhën 2026-2030 është ndërtuar mbi pesë qëllime kryesore, të cilat përfaqësojnë drejtimet strategjike të veprimit të komunës: nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm lokal, përmirësimi i infrastrukturës publike dhe zhvillimi urban, zhvillimi i bujqësisë dhe mbrojtja e mjedisit, fuqizimi i komuniteteve përmes shëndetit, arsimit dhe përfshirjes sociale, fuqizimi i qeverisjes lokale dhe efikasitetit administrativ.

Secili qëllim është i mbështetur me objektiva të qarta dhe projekte të zbatueshme, të cilat synojnë të sjellin ndryshime të prekshme në jetën e përditshme të qytetarëve. Planu promovon një model zhvillimi ku bashkëpunimi ndër-institucional, inovacioni dhe përfshirja qytetare janë elemente kyçe për suksesin. Në fushën ekonomike, strategjia fokusohet në krijimin e kushteve të favorshme për ndërmarrjet vendore, lehtësimin e investimeve për bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe promovimin e inovacionit dhe digjitalizimit si nxitës të konkurrencës. Urbanizimi dhe infrastruktura trajtohen përmes investimeve në transport publik, ndriçim rrugor, kanalizim, ujësjellës dhe hapësira publike funksionale.

Në aspektin mjedisor, strategjia përfshin masa për ruajtjen e burimeve natyrore, zgjerimin e zonave të gjelbra, promovimin e turizmit ekologjik dhe zbatimin e politikave për menaxhimin e mbetjeve dhe energjinë e ripërtëritshme. Në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, synohet modernizimi i infrastrukturës, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe përfshirja aktive e të rinjve në jetën kulturore dhe sportive.

Qeverisja lokale do të përqendrohet në rritjen e efikasitetit administrativ, digjitalizimin e shërbimeve publike, forcimin e transparencës dhe krijimin e mekanizmave për pjesëmarrje të gjerë qytetare në vendimmarrje.

Ky plan strategjik nuk është thjesht një dokument politikash, por një vizion i përbashkët për një Kaçanik më të zhvilluar, më të drejtë dhe më të qëndrueshëm. Zbatimi i tij për periudhën 2026-2030 pritët të sjellë përmirësime të dukshme në cilësinë e jetesës, të rrisë atraktivitetin e komunës për investime dhe të forcojë rolin e saj si një model zhvillimi lokal në nivel kombëtar.

1. HYRJE

Zhvillimi ekonomik lokal është themeli mbi të cilin ndërtohet mirëqenia e qëndrueshme e qytetarëve dhe vitaliteti i një komuniteti. Për komunën e Kaçanikut, ky proces përfaqëson më shumë se një politikë publike, është një vizion për të ardhmen, i mbështetur në potencialin e pasur natyror, trashëgiminë kulturore dhe energjinë e qytetarëve të saj. Nëpërmjet këtij plani, komuna synon të krijojë një ekonomi të qëndrueshme dhe të drejtë, ku secili individ ka mundësi të kontribuojë dhe të përfitojë.

Zhvillimi ekonomik kërkon koordinim të ngushtë mes institucioneve vendore, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe vetë qytetarëve. Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt rezultateve, mund të ndërtohet një sistem ekonomik që i përgjigjet nevojave reale të komunitetit dhe që përballon sfidat e kohës.

Vizioni i komunës së Kaçanikut është: “Kaçaniku me mundësi për të gjithë, i zhvilluar nga burime të shëndosha natyrore dhe krenarë me trashëgiminë e tij”. Ndërsa, misioni i saj është: “Komuna e Kaçanikut është e përkushtuar të zhvillojë një ekonomi lokale të fuqishme dhe të qëndrueshme, duke mbështetur bujqësinë moderne, industrinë inovatore dhe turizmin atraktiv si shtylla kyçe të progresit. Me fokus të veçantë në ruajtjen e një mjedisi të pastër dhe të qëndrueshëm, komuna synon të krijojë një komunitet të shëndetshëm dhe dinamik, të përbërë nga qytetarë mirë të arsimuar dhe me rini aktive në kulturë, sport dhe shoqëri”.

Ky dokument është hartuar në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Komunës së Kaçanikut dhe udhëzimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, duke respektuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Ligji garanton komunave kompetenca të plota për të zhvilluar politika që lidhen me interesin lokal, përfshirë zhvillimin ekonomik, dhe krijon bazën ligjore për një qeverisje të decentralizuar dhe efektive.

Në këtë kuadër, Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2030 për komunën e Kaçanikut është hartuar në përputhje të plotë me Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030. Ky program kombëtar përcakton katër shtylla kryesore: ndërtimin e një ekonomie lokale konkurruese, promovimin e punësimit gjithëpërfshirës, përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe forcimin e qeverisjes efektive, të cilat reflektohen drejtpërdrejt në pesë qëllimet strategjike të komunës së Kaçanikut. Kjo ndërlidhje siguron koherencë vertikale mes nivelit lokal dhe kombëtar, duke e pozicionuar komunën si një kontribuues aktiv në realizimin e vizionit të Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm deri në vitin 2030.

Në kontekstin e reformave të vazhdueshme në vetëqeverisjen lokale në Kosovë, komuna e Kaçanikut e sheh këtë plan si një instrument strategjik për të fuqizuar rolin e saj në zhvillimin ekonomik, për të rritur pjesëmarrjen qytetare dhe për të ndërtuar partneritete të qëndrueshme me sektorin privat dhe organizatat vendore e ndërkombëtare.¹

¹ Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016–2026, fq. 6.

Qëllimet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal në komunën e Kaçanikut për periudhën 2026-2030 janë:

1. Nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm lokal;
2. Përmirësimi i infrastrukturës publike dhe zhvillimi urban;
3. Zhvillimi i bujqësisë dhe mbrojtja e mjedisit;
4. Fuqizimi i komuniteteve përmes shëndetit, arsimit dhe përfshirjes sociale;
5. Fuqizimi i qeverisjes lokale dhe efikasitetit administrativ.

Ky plan është më shumë se një dokument teknik, është një udhërrëfyes për veprim konkret, një platformë për dialog dhe një angazhim për progres. Zbatimi i tij kërkon vizion, përkushtim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm nga të gjitha palët e interesit. Vetëm në këtë mënyrë, komuna e Kaçanikut mund të ndërtojë një të ardhme më të ndritur për qytetarët e saj dhe të pozicionohet si një model i zhvillimit lokal në nivel kombëtar.

2. METODOLOGJIA

Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal (SZHEL) të Komunës së Kaçanikut për periudhën 2026-2030 është realizuar përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe të strukturuar, i cili ka pasur për qëllim përputhjen e dokumentit me realitetin lokal, mundësitë zhvillimore dhe prioritetet strategjike të komunës. Gjatë këtij procesi janë organizuar takime konsultative dhe sesione të punës me akterët lokalë, organizatat komunitare dhe sektorin privat, me qëllim që strategjia të reflektojë sa më saktë nevojat dhe zërin e qytetarëve.

Lista e anëtarëve të grupit punues të komunës dhe të angazhuarve tjerë:

1. Sabedin Vishi - Kryetar i komunës së Kaçanikut
2. Besim Ilazi – ish kryetar i komunës së Kaçanikut
3. Ylber Bajra – ish shef i kabinetit të kryetarit
4. Argjend Guri - Zyrtar për zhvillim, kryesues i grupit punues
5. Agron Dema - Zyrtar për biznese, zëvendëskryesues i grupit punues dhe menaxher
6. Mirlinda Dema - Udhëheqëse e gjendjes civile
7. Kaltrina Luma - Zyrtare e lartë e prokurimit
8. Muhamed Fera - Zyrtar i lartë i financave dhe buxhetit
9. Arbnora Kuka - Zyrtare e lartë për shëndetësi
10. Gafurr Guri - Udhëheqës i sektorit të arsimit
11. Gentiana Kastrati Sallahu - Zyrtare ligjore në DKA
12. Fatmir Çaka – Koordinator për rini dhe të drjetat e fëmijëve
13. Mentor Shehu- Zyrtar i lartë i kadastrit
14. Rufat Muqa - Zyrtar për leje ndërtimore
15. Arditë Shehu - Zyrtare e lartë për mbrojtjen e mjedisit
16. Mustaf Loku - Zyrtar i lartë i bujqësisë
17. Arian Teneqja - Zyrtar për menaxhimin e projekteve (tani drejtor i drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencës
18. Valmir Krasniqi - Zyrtar për ndërtimtari
19. Eljesa Begunca - Zyrtare për hapësira publike
20. Ilir Lumi - Udhëheqës i sektorit ligjor
21. Bujar Dullovi - Inspektor mjedisor
22. Fatlume Guri - Zyrtare e lartë për komunikim
23. Hajredin Ramajli - Zyrtar për privatizim (AKP)
24. Anëtarë/e nga Organizatat e Shoqërisë Civile: Remzi Reka - OJQ “Gjethi”, Shpat Bulica - KVRL, Ylber Tusha - përfaqësues i bizneseve
25. Expertë dhe konsulentë të jashtëm
26. Zyrtarë nga ministria përkatëse (me raste dhe tema specifike).

Në fazat fillestare është hartuar një plan metodologjik, i cili ka përfshirë strategjinë për mbledhjen e të dhënave, qasjen për vlerësimin e kapaciteteve dhe format e përfshirjes së publikut. Informacionet janë grumbulluar nga burime dytësore, duke përfshirë aspektet gjeografike dhe demografike, arsimin, sistemin shëndetësor, mirëqenien sociale, tregun e punës,

infrastrukturën fizike dhe teknologjinë e komunikimit, furnizimin me ujë dhe energji, administratën publike, trashëgiminë kulturore dhe profilin ekonomik lokal të komunës. Këto të dhëna janë pasuruar me të dhëna parësore të mbledhura përmes intervistave individuale, sesioneve të fokus-grupeve, forumeve qytetare dhe pyetësorëve të shpërndarë në komunitet, me qëllim identifikimin e sfidave dhe potencialeve konkrete për zhvillim lokal.

Strategjia është ndërtuar mbi baza të qëndrueshme planifikimi, duke marrë parasysh dokumentet orientuese në nivel kombëtar dhe lokal, si:

- Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2030;
- Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030;
- Programin Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MS);
- Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB);
- Strategjitë e Veprimit në Nivel Lokal dhe
- Udhëzuesin për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.

Për më tepër, janë zhvilluar analiza të thelluara të konkurrueshmërisë së komunës, me fokus te sektorët ekonomikë me potencial të lartë si turizmi natyror, bujqësia , artizanati dhe shërbimet digjitale. Strategjia gjithashtu merr parasysh ndikimet klimatike dhe nevojën për zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë masa për përmirësimin e eficiencës energjetike, promovimin e transportit të gjelbër dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.

Figura në vijim paraqet procesin metodologjik të ndjekur gjatë hartimit të SZHEL për periudhën 2026-2030, përfshirë hapat analitikë, fazat konsultative dhe kontributet institucionale.

Fig. 1 Metodologjia e punës



Procesi për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal (SZHEL) të Komunës së Kaçanikut për periudhën 2026-2030 është zhvilluar përmes një sërë hapash të ndërthurur, që garantojnë një qasje gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete.

Në fazën fillestare, u bë identifikimi i palëve të interesit dhe formimi i grupit punues shumësektorial, përfaqësuar nga zyrtarë komunalë, përfaqësues të sektorit privat, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të komunitetit. Ky grup u shndërrua në një platformë të rëndësishme bashkëpunimi dhe dialogu, ku u reflektuan interesat dhe nevojat e ndryshme lokale, duke siguruar përfaqësim të barabartë dhe gjithëpërfshirës në të gjitha fazat e procesit. Pas formimit të grupit punues, u zhvillua faza e mbledhjes së të dhënave. Ky proces analitik përfshiu grumbullimin e informatave nga burime të ndryshme, përfshirë të dhëna statistikore dhe dokumente zyrtare (burime dytësore), si dhe informacione të mbledhura përmes intervistave individuale, diskutimeve në fokus-grupe dhe pyetësorëve (burime parësore).

Në vijim, u realizua analiza SWOT, e cila përbën një komponentë kyçe për vlerësimin e gjendjes aktuale dhe orientimin strategjik. Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e përparësive dhe dobësive të komunës, mundësive zhvillimore dhe sfidave. Rezultatet e analizës u përdorën për të formësuar prioritetet strategjike dhe për të udhëzuar hartimin e objektivave afatshkurtra dhe afatgjata. Analiza SWOT shënoi një fazë të rëndësishme të procesit, duke identifikuar forcat, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që ndikuan në zhvillimin ekonomik të komunës. Kjo analizë u përdor për të vlerësuar potencialet ekzistuese dhe për të përcaktuar prioritetet kryesore.

Procesi vijoi me draftimin e dokumentit strategjik, ku u zhvilluan konsultime të hapura me komunitetin dhe akterët institucionalë. Sugjerimet dhe komentet e marrë nga këto sesione u integruan në mënyrë konstruktive, duke përmirësuar përmbajtjen dhe rritur transparencën e procesit. Faza përmbyllëse përfshiu përgatitjen e versionit final të strategjisë dhe miratimin e saj nga organet kompetente komunale. Ky moment shënoi institucionalizimin e dokumentit dhe konfirmimin se hartimi ishte në përputhje me standardet kombëtare të planifikimit strategjik dhe praktikën e mira të qeverisjes lokale.

Në tërësi, ky proces ka vendosur një themel të fortë për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, konsolidimin e partneriteteve lokale dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve të Kaçanikut, përmes një dokumenti që pasqyron realitetin lokal, vizionin kolektiv dhe angazhimin për veprim të përbashkët.

3. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT KYÇE

Deklarata e vizionit, misionit dhe vlerave kryesore të komunës së Kaçanikut paraqesin shtyllën themelore të zhvillimit strategjik të saj për periudhën 2026-2030. Këto parime udhëheqëse artikulojnë qartë ambiciet afatgjata të komunës për një shoqëri dinamike, të barabartë dhe të qëndrueshme, duke orientuar vendimmarrjen institucionale dhe përcaktimin e prioriteteve në të gjitha nivelet e qeverisjes lokale.

Nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në transparencë, inovacion dhe përgjegjësi publike, komuna synon të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetës së qytetarëve, të forcojë kohezionin social dhe të nxisë një klimë të favorshme për zhvillim ekonomik dhe investime të qëndrueshme.

Vizioni për komunën e Kaçanikut synon të ndërtojë një qendër të gjallë ekonomike ku secili qytetar ka mundësi të barabarta për zhvillim dhe mirëqenie. Duke u mbështetur në pasuritë natyrore të qëndrueshme dhe duke ruajtur me krenari trashëgiminë kulturore e historike, Kaçaniku aspirojnë një administratë komunale moderne, një mjedis të pastër dhe të gjelbër, infrastrukturë të përparuar, shërbime publike cilësore, veçanërisht në shëndetësi dhe arsim dhe një hapësirë gjithëpërfshirëse që frymëzon jetë aktive dhe investime afatgjata.

Deklaratat e vizionit dhe misionit të komunës së Kaçanikut, janë prezantuar në vijim.




Pra, vizioni i komunës së Kaçanikut është: *“Kaçaniku me mundësi për të gjithë, i zhvilluar nga burime të shëndosha natyrore dhe krenarë me trashëgiminë e tij”*. Ndërsa, misioni i saj është: *“Komuna e Kaçanikut është e përkushtuar të zhvillojë një ekonomi lokale të fuqishme dhe të*

qëndrueshme, duke mbështetur bujqësinë moderne, industrinë inovatore dhe turizmin atraktiv si shtylla kyçe të progresit. Me fokus të veçantë në ruajtjen e një mjedisi të pastër dhe të qëndrueshëm, komuna synon të krijojë një komunitet të shëndetshëm dhe dinamik, të përbërë nga qytetarë të arsimuar dhe me rini aktive në kulturë, sport dhe shoqëri”.

Vlerat kyçe të komunës së Kaçanikut përfaqësojnë parimet themelore që udhëheqin zhvillimin dhe qeverisjen lokale. **Zhvillimi ekonomik dhe inovacioni** është një ndër prioritetet kryesore, duke përkrahur bujqësinë, industrinë dhe turizmin si motorë të progresit, ndërsa nxitja e ideve kreative kontribuon në një ekonomi konkurruese dhe të qëndrueshme. Në qendër të vizionit institucional qëndron **qëndrueshmëria mjedisore**, përmes ruajtjes së pasurive natyrore dhe orientimit drejt zhvillimit ekologjik afatgjatë. Qeverisja e komunës mbështetet në **transparencë dhe integritet institucional**, duke ofruar një administratë të ndershme, të hapur dhe llogaridhënëse që forcon besimin e qytetarëve. **Pjesëmarrja aktive e qytetarëve** është thelbësore për ndërtimin e një demokracie lokale funksionale, ku dialogu publik dhe vendimmarrja e përbashkët janë pjesë integrale e jetës komunale. **Arsimi cilësor dhe fuqizimi i komunitetit** përbëjnë një tjetër vlerë, duke investuar në formimin e gjeneratës së re dhe përfshirjen e saj në zhvillimin kulturor, sportiv dhe shoqëror. Më në fund, **mirëqenia sociale dhe barazia** shprehin angazhimin e komunës për të garantuar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës, ku çdo qytetar ka qasje të barabartë në shërbime dhe mundësi për jetesë të dinjitetshme.

Fig. 2 Vlerat kyçe të komunës së Kaçanikut



4. ANALIZA E GJENDJES SOCIO-EKONOMIKE

Ky seksion përshkruan gjendjen socio-ekonomike të komunës së Kaçanikut, duke ofruar një pamje gjithëpërfshirëse mbi faktorët që ndikojnë zhvillimin ekonomik lokal. Fillimisht, prezantohen karakteristikat gjeografike të territorit, struktura demografike dhe vendbanimet, përfshirë migrimin dhe dinamikën e lëvizjes së popullsisë. Po ashtu, paraqitet gjendja e arsimit dhe shëndetësisë, si dhe roli që luajnë në mirëqenien e përgjithshme të banorëve. Shërbimet sociale dhe administrative analizohen në funksion të përmbushjes së nevojave qytetare, ndërsa infrastruktura dhe sistemet e telekomunikacionit vlerësohen për ndikimin që kanë në zhvillimin ekonomik e kulturor. Dimensionin kulturor merr vëmendje të veçantë, si element që pasqyron identitetin dhe kohezionin komunitar, përmes trashëgimisë, ngjarjeve kulturore dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në jetën publike të komunës.

Pjesa e dytë përqendrohet në aspektet financiare dhe ekonomike të komunës, duke përfshirë strukturën dhe përdorimin e buxhetit komunal. Identifikohen sektorët kyç të aktivitetit ekonomik, potencialet për investime dhe sfidat që duhet adresuar për të siguruar rritje të qëndrueshme.

HISTORIK I SHKURTËR I KOMUNËS – Kaçaniku, fillimisht një qendër administrative rurale dhe më vonë një qytezë e formuar historikisht, ka rrënjët e veta që datojnë nga fundi i shekullit XVI. Deri në vitin 1891, kjo zonë ishte pjesë e nahijes së Sanxhakut të Shkupit brenda Vilajetit të Kosovës, duke pasur një rol të rëndësishëm në organizimin territorial të asaj kohe.

Sipas burimeve historike, themelimi i qytezës lidhet me Koxha Sinan Pashën, një figurë me prejardhje shqiptare që shërbente si pasha në Perandorinë Osmane. Kontributi i tij urbanistik përfshinte ndërtimin e një xhamie, ende funksionale sot, një imaret (kuzhinë publike për të varfrit), një shkollë pranë xhamisë, dy bujtina, një hamam dhe kalanë e Kaçanikut. Po ashtu, ai ndërtoi edhe disa mullinj përgjatë lumit Lepenc, duke i dhënë jetës qytetare një strukturë të zhvilluar për kohën.

Trashëgimia kulturore dhe historike e Kaçanikut është e thellë dhe e pasur. Qyteti njihet për qëndresën e tij nëpër të gjitha etapat e historisë shqiptare, duke qenë simbol i luftës dhe përkushtimit ndaj lirisë. Monumentet, traditat, dhe vendet e trashëgimisë janë dëshmi të këtij karakteri historik, duke i dhënë Kaçanikut një identitet unik në kujtesën kombëtare.²

Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën juglindore të Republikës së Kosovës dhe përfaqëson rreth 1.94% të territorit të përgjithshëm të vendit. Struktura territoriale e komunës përbëhet nga gjithsej 31 vendbanime, prej të cilave vetëm një ka karakter urban, ndërsa 30 të tjera janë zona rurale. Kaçaniku kufizohet me komunat Viti, Ferizaj dhe Shtërpçë, ndërsa në pjesën jugore kufizohet me komunën e Hani Elezit dhe me Republikën e Maqedonisë së Veriut.³

² Profili ekonomik i komunës së Kaçanikut, 2023, fq.3.

³ Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për periudhën 2026-2028, fq. 4.

POZITA DHE VEÇORITË GJEOGRAFIKE – Komuna e Kaçanikut ndodhet në pjesën juglindore të Kosovës dhe kufizohet me disa komuna dhe shtete fqinje. Në veri ajo kufizohet me komunën e Ferizajt, në verilindje me Vitinë, në perëndim me Shtërpçen dhe në jug me Hanin e Elezit. Gjithashtu, në juglindje dhe perëndim, Kaçaniku kufizohet me Maqedoninë e Veriut, ku ndodhet edhe pika kufitare Gllaboçica. Gjatësia totale e vijës kufitare të komunës është 101.41 km, ndërsa sipërfaqja e saj përfshin 211.13 km².

Fig. 3 Pozita gjeografike e komunës së Kaçanikut



Territori i komunës shtrihet kryesisht në zona malore, përveç pjesës veriore që përfshin pjesën jugore të Fushës së Kosovës, e cila karakterizohet nga terren i ulët. Pikat më të largëta të territorit të Kaçanikut janë fshatrat Sllatinë në perëndim dhe Korbliq në lindje, me një distancë prej 22.3 kilometrash mes tyre. Kjo vijë gati përputhet me drejtimin e paralelit, ndërsa në drejtimin veri-jug dallimet gjeografike nuk janë shumë të theksuara.

Forma e sipërfaqes së komunës është e parregullt dhe mjaft e thyer, duke reflektuar një reliev të larmishëm. Lakueshmëria e vijës kufitare komunale, e shprehur përmes

koeficientit, ka vlerën 1.7. Kjo do të thotë se gjatësia e vijës kufitare është 1.7 herë më e madhe se perimetri i një rrethi me të njëjtën sipërfaqe, duke dëshmuar kompleksitetin e konturit territorial të Kaçanikut.

Kaçaniku shquhet për pozitën e tij gjeografike dhe klimën e favorshme që e bën të dallueshëm në jug të Kosovës. Gryka e Kaçanikut shërben si kanal natyror ku depërton klima mesdhetare, duke e pasuruar zonën me një butësi klimaterike të pazakontë për rajonet malore. Nga lindja dhe perëndimi ndihen ndikimet e klimës kontinentale malore, gjë që krijon një përzierje klimatike të veçantë. Qysh para Luftës së Dytë Botërore, klimatologët kishin konstatuar se në juglindje të Kaçanikut takohen klima mesdhetare e ngrohtë me atë kontinentale të ftohtë, një fenomen që ndikon drejtpërdrejt në bujqësi, biodiversitet dhe jetesën e banorëve.

Qyteti përshkohet nga dy lumenj, Lepenci dhe Nerodimja, të cilët bashkohen në fund të Kaçanikut dhe përshkojnë së bashku grykën e tij piktoreske. Ky peizazh jo vetëm që e bën qytetin vizualisht tërheqës, por edhe shërben si burim i rëndësishëm natyror për ujë, energji dhe rekreacion. Përveç kësaj, Kaçaniku gëzon pasuri të mëdha të pyjeve të dendura dhe të bukura, tokës pjellore dhe ujërave të pastra, duke u cilësuar si një nga zonat më të pasura të trojeve shqiptare në aspektin natyror.⁴

⁴ Plani i veprimit në mjedis, 2025, fq. 10.

Territori i Kaçanikut përfshin një morfologji të larmishme, ku dallohen disa njësi kryesore: malet e Sharrit në jugperëndim dhe veriperëndim, malet e Karadakut në lindje, si dhe pjesa më jugore e fushëgropës së Kosovës. Lugina e Kaçanikut, e cila përshkohet nga lumi Lepenc, përbën nivelin bazë të erozionit për relievet kodrinore dhe malore që e rrethojnë, të cilat janë në proces të vazhdueshëm ngritjeje.

Shpatet perëndimore të maleve të Sharrit, që shtrihen në jugperëndim të Kaçanikut, karakterizohen nga pjerrësi të theksuar dhe përmbajnë lartësitë më të mëdha të territorit, si Maja e Lubotenit me 2,498 metra mbi nivelin e detit. Në lindje ndodhet masivi i Karadakut, me orientim jugperëndim-verilindje, i cili përbëhet kryesisht nga relievet kodrinoro-malor dhe malor. Në mes të këtyre formacioneve ndodhet lugina e ngushtë e Kaçanikut, e formuar nga lumi Lepenc. Kjo luginë ka një gjatësi prej rreth 7 kilometrash dhe një gjerësi mesatare prej 0.5 kilometra, duke përmbajtur edhe pikën më të ulët të territorit me 396 metra mbi nivelin e detit. Pjesa veriore e Kaçanikut përfshin skajin jugor të fushëgropës së Kosovës, e cila në lindje lidhet me fushën e Moravës së Binçës. Brenda territorit të Kaçanikut, kjo fushë ngushtohet në 4-5 kilometra, ndërsa gjatësia e saj arrin deri në 10-12 kilometra, duke reflektuar ndryshime të dukshme strukturore.

Sa i përket shpërndarjes së relievit sipas lartësisë, rreth 39% e territorit ndodhet në kuotat deri në 700 metra, që përfaqësojnë relievet të ulët deri mesatar. Rreth 30% përfshin zona kodrinore-malore me lartësi nga 700 deri në 900 metra. Relievet malore të ulëta dhe mesatare zënë 21.5% të sipërfaqes, ndërsa relievet e larta malore, që përfshijnë kryesisht zonën jugperëndimore të komunës (malet e Sharrit), përbëjnë 9.5% të territorit.⁵

Klima: Klima e komunës së Kaçanikut është e mesme kontinentale, si pasojë e pozicionit të saj në gjerësitë mesatare gjeografike të Kosovës. Në zonat më të larta, si malet e Sharrit dhe Karadakut, mbizotëron klima malore, më e ashpër dhe më e ftohtë. Lugina e ngushtë e Lepencit, me formën e saj të lakuar, kufizon depërtimin e ngrohtësisë nga rajoni i Shkupit, ndërsa lumenjtë kontribuojnë në freskinë dhe lagështinë e ajrit.

Dallimet hipsometrike ndikojnë ndjeshëm në klimën e vendbanimeve. Me një disnivel prej 2,102 metrash midis pikës më të ulët dhe më të lartë, ndryshimi i temperaturës mund të arrijë deri në 11.7°C. Klima e Kaçanikut karakterizohet nga luhajtje të ndjeshme mujore dhe sezonale. Temperaturat mesatare 15 vjeçare tregojnë një mesatare vjetore prej 10.2°C. Janari është muaji më i ftohtë me -1.4°C, ndërsa korriku më i ngrohti me 20.6°C. Ekstremet termike shënojnë -26°C në janar dhe 37.3°C në gusht, me një amplitudë maksimale prej 63.3°C. Zona e Gllloboçicës ka klimë më të butë për shkak të ndikimit nga Pollogu dhe fushëgropa e Shkupit.

Reshjet vjetore mesatare janë 858 mm, mbi mesataren kombëtare prej 784 mm. Nëntori është muaji më i lagësht me 121.4 mm, ndërsa gushti më i thatë me 40.4 mm. Duke e lidhur këtë sasi me sipërfaqen e komunës (211.13 km²), rezulton se bien rreth 189.42 milionë metra kub ujë në vit. Reshjet janë të paqëndrueshme, me maksimumin absolut prej 286.8 mm në shkurt (33% e totalit vjetor) dhe minimumin ekstrem prej vetëm 0.4 mm në korrik. Thatësia mund të zgjasë deri në 65 ditë, veçanërisht në muajt nëntor dhe dhjetor, por sipas mesatares, asnjë muaj nuk

⁵ Plani i veprimt në mjedis, 2025, fq. 11.


klasifikohet si plotësisht i thatë. Korriku, gushti dhe shtatori janë mesatarisht të thatë, ndërsa muajt e tjerë kanë regjim të lagësht.

Kaçaniku përjeton mesatarisht 30.6 ditë me borë në vit, ndërsa mbulesa e borës zgjat rreth 47 ditë. Janari ka numrin më të madh të ditëve me borë (14.9 ditë), dhe trashësia mund të arrijë deri në 64 cm, duke ndikuar ndjeshëm në jetën e përditshme. Në zonat e Sharrit, shtresa e borës mbi 1-2 metra është e zakonshme. Dita e parë me borë zakonisht është 30 nëntori, më e hershja 5 nëntori, ndërsa e fundit 23 marsi, me raste deri më 27 prill. Këto të dhëna i referohen qytetit të Kaçanikut, ndërsa në zonat malore periudha e borës është më e gjatë.


Insolacioni vjetor është 2,035.8 orë me diell. Korriku ka maksimumin me 264 orë, ndërsa mbulimi mesatar i qiellit me re është 57%, duke lëvizur nga 33% në korrik deri në 74% në janar. Për shkak të shtrirjes veri-jug të luginës dhe pozicionit të maleve në lindje dhe perëndim, ekspozimi ndaj diellit është i kufizuar dhe i pabarabartë, i ndikuar nga relievi i thyer i territorit.⁶

POPULLSIA – Sipas regjistrimit më të fundit të vitit 2024, komuna e Kaçanikut ka gjithsej **27,716 banorë**. Të dhënat që pasqyrojnë ndryshimet në numrin e popullsisë nga viti 1948 deri në vitin 2024 janë prezantuar në grafikonin nr. 1, duke ofruar një pamje të qartë të zhvillimeve demografike ndër vite

Statistikat e popullsisë së Komunës së Kaçanikut tregojnë luhatje të dukshme gjatë periudhës 1948–2024. Nga viti 1948 deri në 1961, popullsia u rrit me 21.1%, duke reflektuar një zhvillim të moderuar. Në periudhën 1961–1981, rritja ishte më e theksuar, me një shtim prej 59%, që lidhet me zgjerimin urban dhe migrimin e brendshëm. Nga 1981 deri në 2011, popullsia vazhdoi të rritet me 33.5%, por me një ritëm më të ngadalësuar, i ndikuar nga faktorë socio-politikë dhe ekonomikë. Ndërkohë, periudha 2011–2024 shënoi një rënie prej 17%, duke reflektuar sfida të reja demografike, si migrimi jashtë vendit dhe ndryshimet në strukturën familjare.



Graf. 1 Popullsia në komunën e Kaçanikut sipas regjistrimeve, periudha 1948-2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia sipas vendbanimeve në komunën e Kaçanikut, 1948-2024*


⁶ Plani i veprimtimit në mjedis, 2025, fq. 12.

Dendësia: Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna e Kaçanikut kishte një dendësi prej rreth 158 banorësh për km². Në regjistrimin e vitit 2024, popullsia ra në 27,716 banorë, duke ulur dendësinë në 131 banorë/km².

Ky ndryshim pasqyron një rënie të dukshme demografike gjatë dekadës, e ndikuar nga migrimi i brendshëm, emigrimi jashtë vendit dhe faktorë socio-ekonomikë. Ulja e dendësisë kërkon rishikimin e planifikimit urban dhe të strategjive të zhvillimit, me qëllim që ato të përshtaten me realitetin aktual të komunitetit.

Shtimi natyror: Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudhën 2022–2024 pasqyrojnë lëvizje të ndjeshme në indikatorët demografikë. Shtimi natyror ka shënuar rënie të theksuar, me një ulje prej 19.0% në vitin 2023 krahasuar me vitin paraprak, dhe një rënie më të lehtë prej 1.4% në vitin 2024. Po ashtu, nataliteti ka pësuar zvogëlim progresiv: 9.8% më pak në vitin 2023 dhe 2.6% më pak në vitin 2024. Mortaliteti ka ndjekur një trajektore të ngjashme, me një rënie prej 23.5% në vitin 2023 dhe 0.74% në vitin 2024. Këto ndryshime statistikore pasqyrojnë faktorë të shumtë që ndikojnë në strukturën demografike të komunës, përfshirë tendencat e migrimit, ndryshimet socio-ekonomike dhe transformimet në dinamikën familjare.


Graf. 2 Shtimi natyror në komunën e Kaçanikut, periudha 2022-2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror në nivel të komunave, 2021-2023.*

Struktura gjinore: Sipas regjistrimit të vitit 2024, struktura gjinore në komunën e Kaçanikut është pothuajse e balancuar. Meshkujt përbëjnë 50.64% të popullsisë (14,035 banorë), ndërsa femrat 49.36% (13,681 banorë), duke reflektuar një ndarje të barabartë në përfaqësimin demografik.


Graf. 3 Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Kaçanikut



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Kaçanikut sipas gjinisë 2024.*

Struktura etnike: Struktura etnike e popullsisë në komunën e Kaçanikut karakterizohet nga një homogjenitet i theksuar, ku shqiptarët përbëjnë 99.89% të banorëve. Grupet e tjera etnike përfaqësohen në përqindje shumë të vogla: serbët, boshnjakët dhe romët secili me nga 0.02%, ndërsa 0.05% i përkasin komuniteteve të tjera. Për një pasqyrë vizuale të kësaj ndarjeje, përqindjet janë paraqitur në figurën në vijim, duke reflektuar përbërjen e plotë prej 100%.


Graf. 4 Struktura etnike e popullsisë në komunën e Kaçanikut



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Kaçanikut sipas etnicitetit 2024.*

Struktura religjioze: Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Kaçanikut paraqitet si jashtëzakonisht homogjene. Sipas të dhënave më të fundit nga viti 2024, 99.89% e banorëve identifikohen me besimin islam. Grupet e tjera fetare përfaqësohen me përqindje minimale: 0.01% i përkasin besimit ortodoks, 0.02% besimit katolik, ndërsa 0.77% e popullsisë nuk janë deklaruar ose i përkasin besimeve të tjera. Për një pasqyrë vizuale të kësaj ndarjeje, përqindjet janë paraqitur në figurën në vijim, duke përfaqësuar ndarjen e plotë prej 100%.

Graf. 5 Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Kaçanikut




Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Kaçanikut sipas religjionit 2024.*

Struktura moshore: Struktura moshore e komunës së Kaçanikut karakterizohet nga një profil i ri dhe energjik. Sipas të dhënave të vitit 2024, rreth 41% e banorëve janë nën moshën 24 vjeç, duke përbërë një bazë rinore të fuqishme që mund të luajë rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe social të komunës. Në anën tjetër, vetëm 9.6% e popullsisë i takojnë grupmoshës mbi 65 vjeç, e cila zakonisht konsiderohet si joaktive në tregun e punës. Ky raport tregon një strukturë demografike të orientuar drejt moshave aktive dhe produktive, me potencial të lartë për zhvillim të qëndrueshëm.

Për një pasqyrë më të detajuar, figura në vijim paraqet ndarjen e popullsisë sipas grupmoshave.

Graf. 6 Struktura moshore e popullsisë në komunën e Kaçanikut



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Kaçaniku sipas grupmoshës 2024.*

VENDBANIMET – Linjat rrugore dhe hekurudhore, së bashku me rrugët që lidhin Kaçanikun përgjatë luginës së Lepencit dhe asaj të Nerodimes, si dhe rrugët malore që kalojnë përmes maleve të Sharrit dhe Karadakut, kanë krijuar një rrjet të përsosur lidhjesh fizike mes vendbanimit të Kaçanikut dhe zonave rurale përreth. Këto vendbanime rurale ndahen në tri kategori kryesore, bazuar në karakteristikat e tyre natyrore dhe ekonomike.

- **Vendbanimet përgjatë luginave të lumenjve** përfshijnë fshatrat Sllatinë, Dubravë, Doganaj, Soponicë, Rekë, Nikaj, Biçec, Kovaqec, Bob, Runjevë, Stagovë dhe Korbliq. Këto zona janë zhvilluar falë tokave pjellore që ndodhen përgjatë lumenjve Lepenc, Nerodime dhe Morava, të cilat kanë ofruar kushte të favorshme për bujqësi dhe vendbanim të qëndrueshëm.
- **Vendbanimet në terrene kodrinore** përfshijnë fshatrat Kotlina, Ivaja, Gajrja, Strazha, Gllaboçica, Gërlica e Epërme, Gjurgjedelli, Llanishta, Drenogllava, Semaja dhe Nikoci. Këto fshatra karakterizohen nga një ekonomi e bazuar kryesisht në blegtori, e cila ka qenë aktiviteti kryesor dhe i përbashkët për banorët e këtyre zonave.
- **Vendbanimet në terrene të ulëta** përfshijnë fshatrat Elezaj, Duraj, Gabrrica, Bajnica, Koxhaj, si dhe pjesët më të reja të Kaçanikut të Vjetër dhe Doganaj, që shtrihen në ultësirën e Kosovës. Po ashtu, fshati Begracë ndodhet në ultësirën e Moravës. Këto zona

kanë përfituar nga relievi i sheshtë, duke mundësuar zhvillim të lehtë urban dhe qasje më të mirë infrastrukturore.⁷

Komuna e Kaçanikut përfshin gjithsej 31 vendbanime, të shpërndara në një territor me karakter kryesisht rural. Shumica e këtyre vendbanimeve kanë popullsi të vogël: 24 prej tyre numërojnë më pak se 1,000 banorë secili, duke reflektuar një përbërje të decentralizuar dhe të lidhur ngushtë me natyrën dhe traditën lokale.

Qyteti i Kaçanikut, me 8,276 banorë sipas të dhënave të vitit 2024 nga ASK, përfaqëson qendrën kryesore urbane të komunës dhe shërben si nyje administrative, ekonomike dhe kulturore për zonën. Struktura e shpërndarjes së popullsisë tregon se rreth 30% e banorëve jetojnë në zonën urbane, ndërsa pjesa dërrmuese, afërsisht 70% janë të vendosur në vendbanime rurale. Ky raport pasqyron një komunë me potencial të lartë për zhvillim të qëndrueshëm rural, ku ruajtja e identitetit lokal dhe përfshirja e komuniteteve të vogla mbeten thelbësore për politikën e ardhshme territoriale

Numri total i ekonomive familjare në komunën e Kaçanikut arrin në 5,908, duke treguar një shpërndarje të ndryshme ndërmjet vendbanimeve. Qyteti i Kaçanikut përmban numrin më të madh të ekonomive familjare, me 1,855, ndërsa vendbanimet më të vogla regjistrojnë numra minimalë deri në tri (3) ekonomi familjare.

Fig. 4 Pamje e lumit Nerodime



⁷ Plani i veprimtimit në mjedis, 2025, fq. 22 (Disa pjesë korrigjuar nga komuna).

Tab. 1 Popullsia e komunës së Kaçanikut sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare

Nr.	VENDBANIMI	POPULLSIA	EKONOMITË FAMILJARE
1	Kaçanik	8,276	1,855
2	Kaçanik i Vjetër	2,576	529
3	Begracë	1,904	393
4	Biqec	1,454	292
5	Vatë	1,399	288
6	Bob	1,377	292
7	Kovaçec	1,017	211
8	Soponicë	969	206
9	Stagovë	960	205
10	Doganaj	903	176
11	Gllaboçicë	818	180
12	Nikaj	708	151
13	Runjevë	691	144
14	Rekë	570	128
15	Duraj	536	112
16	Elezaj	500	106
17	Bajnicë	492	97
18	Gajre	450	89
19	Dubravë	419	93
20	Gabricë	331	80
21	Gërlicë e Epërme	325	64
22	Gjurgjedell	250	44
23	Strazhë	200	38
24	Semajë	124	28
25	Llanishtë	117	24
26	Ivajë	114	29
27	Sllatinë	99	21
28	Kotlinë	85	22
29	Korbliq	33	5
30	Drenogllavë	15	3
31	Nikoc	4	3
Gjithsej		27,716	5,908


Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Kaçanikut sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare 2024.*

Bazuar në të dhënat më të fundit për popullsinë e komunës së Kaçanikut, 31 vendbanimet mund të klasifikohen sipas madhësisë demografike në këto kategori: vetëm një vendbanim (3.23%) ka mbi 5,000 banorë; një tjetër (3.23%) ka ndërmjet 2,000 dhe 4,999 banorë; pesë vendbanime (16.13%) numërojnë nga 1,000 deri në 1,999 banorë; nëntë vendbanime (29.03%) kanë nga 500

deri në 999 banorë; ndërsa pjesa më e madhe, 15 vendbanime (48.39%) kanë më pak se 500 banorë.

Kjo shpërndarje tregon një strukturë të fragmentuar demografike, ku dominimi i popullsisë është përqendruar kryesisht në qytetin e Kaçanikut, si qendër urbane kryesore. Për një pasqyrë më të detajuar të këtyre të dhënave, referojuni grafikoni dhe tabelës në vijim.

Graf. 7 Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Kaçanikut



Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e kaçanikut mund të kategorizohen si në vijim.


Tab. 2 Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Kaçanikut

Deri në 500 banorë	500-999 banorë	1,000-1,999 banorë	2,000-4,999 banorë	Mbi 5000 banorë
Bajnicë Gajre Dubravë Gabricë Gërlicë e Epërme Gjurgjedell Strazhë Semajë Llanishtë Ivajë Sllatinë Kotlinë Korbliq Drenogllavë Nikoc	Soponicë Stagovë Doganaj Gllloboçicë Nikaj Runjevë Rekë Duraj Elezaj	Begracë Biqec Vatë Bob Kovaçec	Kaçanik i Vjetër	Kaçanik

Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Kaçanikut sipas vendbanimit, 2024.*

Në vijim është paraqitur grafikisht, numri i popullsisë sipas vendbanimeve, bazuar në regjistrimet 1948-2024.

Graf. 8 Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948-2024




Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Kaçanikut sipas vendbanimit, 1948-2024.*

Regjistrimet e popullsisë në vendbanimet e komunës së Kaçanikut, nga viti 1948 deri në vitin 2024, pasqyrojnë dinamika të ndryshme demografike në nivel lokal. Disa vendbanime si Kaçanik i Vjetër, Begracë, Biqec dhe Vatë kanë shënuar rritje të qëndrueshme ndër dekada, duke reflektuar zhvillim urban dhe migrim të brendshëm. Në të kundërt, vendbanime si Ivajë, Korbliq, Kotlinë dhe Nikoc kanë përjetuar rënie të ndjeshme në numër banorësh, veçanërisht pas vitit 1991, duke sinjalizuar shpërngulje dhe ndryshime në strukturën familjare. Qyteti i Kaçanikut mbetet qendra kryesore urbane, me rritje deri në vitin 2011 dhe një rënie të lehtë në vitin 2024.

MIGRIMI - Migrimi përfaqëson procesin e lëvizjes së njerëzve nga një vend në tjetrin, i motivuar nga qëllime të ndryshme, si vendosja e përkohshme apo e përhershme. Ky fenomen ka ndikim të thellë mbi kulturën, mënyrën e jetesës dhe orientimin politik të një kombi.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në komunën e Kaçanikut migrimi kombëtar gjatë vitit 2023 ka shënuar një rritje jashtëzakonisht të lartë prej rreth 360% krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë, edhe viti 2022 kishte regjistruar një rritje prej 31.6% në krahasim me vitin 2021.

Nga ana tjetër, migrimi ndërkombëtar në vitin 2023 ka pësuar një rënie të konsiderueshme prej 96%, ndërsa në vitin 2022 kishte shënuar një rënie më të moderuar prej 16% krahasuar me vitin 2021. Detaje më të hollësishme mund të gjenden në tabelat e mëposhtme.



Tab. 3a Migrimi kombëtar në komunën e Kaçanikut, periudha 2021-2023

Migrimi kombëtar	2022	2023	2024
Imigrimi	123	206	216
Emigrimi	241	592	622
Bilanci i migrimit kombëtar	-118	-386	-406

Tab. 3b Migrimi ndërkombëtar në komunën e Kaçanikut, periudha 2021-2023

Migrimi ndërkombëtar	2022	2023	2024
Imigrimi	81	140	216
Emigrimi	230	395	696
Bilanci i migrimit ndërkombëtar	-149	-255	-480

Burimi: ASKDATA: *Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi, 2022 – 2024.*

ARSIMI – Arsimi në Kosovë përfaqëson shtyllën themelore për ndërtimin e një shoqërie të zhvilluar, dinamike dhe gjithëpërfshirëse. Ai nuk shërben vetëm si një mjet për barazi shoqërore, por luan një rol vital në krijimin e kapitalit njerëzor të aftë për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme. Përmes përfshirjes së të gjithë qytetarëve, pa dallim prejardhjeje apo statusi ekonomik, arsimi kontribuon fuqishëm në fuqizimin e tregut të punës, inovacionin, dhe përsheptimin e zhvillimit ekonomik të vendit.

Sistemi arsimor në Kosovë: Sistemi arsimor në Kosovë (komuna) përfshin katër nivele kryesore: parafillor, fillor të mesëm dhe të mesëm të lartë. Klasa parafillor, arsimi fillor dhe i mesëm janë të obligueshëm dhe sigurojnë përfshirje gjithëpërfshirëse në edukim. Arsimi i lartë u jep të rinjve mundësi për zhvillim të mëtejshëm akademik dhe profesional.

Përkundër sfidave si infrastrukturë e dobët dhe cilësi e paqëndrueshme e mësimdhënies, përpjekjet për modernizim të kurrikulave dhe përfshirje sociale janë në rritje. Arsimi mbetet një ndër shtyllat kyçe për progresin e vendit dhe për ndërtimin e një shoqërie konkurruese në nivel global.

Që nga viti 2002, sistemi arsimor në Kosovë ndjek modelin 5+4+3: pesë vite arsimit fillor, katër vite shkollim të mesëm të ulët dhe tre ose katër vite shkollim të mesëm të lartë. Ky strukturim gradual synon të përgatisë të rinjtë për studime të mëtejshme dhe tregun e punës, duke mbështetur një zhvillim të qëndrueshëm arsimor.

Struktura arsimore në komunën e Kaçanikut ndjek modelin e tri niveleve:

1. Arsimit parafillor 0–5 vjeç;
2. Arsimit fillor dhe i mesëm i ulët prej klasës I deri në klasën IX;
3. Arsimit i mesëm i lartë prej klasës X deri në klasën XII.

Bazuar në të dhënat e komunës, gjatë vitit shkollor 2024/2025 kanë funksionuar 11 shkolla amë fillore dhe të mesme të ulëta dhe 10 paralele të ndara fizike.

Arsimi parashkollor dhe parafillor: Sipas të dhënave nga ASK, në komunën e Kaçanikut funksionon vetëm një çerdhe për fëmijët nën moshën 5 vjeç. Megjithatë, shumica e shkollave fillore në nivel vendi ofrojnë arsim njëvjeçar për fëmijët 5 dhe 6 vjeçarë, si pjesë e arsimit parashkollor.

Në Qendrën për Edukimin dhe Arsimin Parashkollor, e cila ofron qëndrim tërë-ditor, realizohet edukimi dhe zhvillimi i hershëm i fëmijëve nga mosha 9 muajsh deri në 6 vjeç. Aktivitetet arsimore dhe kujdesi ndahen sipas grup-moshave, duke u përshtatur me nevojat specifike të secilit stad zhvillimor. Grupi i parë përfshin fëmijët nga 9 muaj deri në 2 vjeç, pasuar nga grupet 2–3 vjeç, 3–4 vjeç, 4–5 vjeç dhe më pas grupi 5–6 vjeç, që njihet si grupi parafillor dhe përgatitor për shkollim fillor.⁸

Statistikat e ASK-së tregojnë se pjesëmarrja në këtë nivel vazhdon të jetë e ulët, por me tendencë përmirësimi: gjatë vitit shkollor 2022/2023 ishin 72 fëmijë pjesëmarrës, ndërsa në 2023/2024 numri u rrit në 96, që përfaqëson një rritje prej 33.3%.

Sipas të dhënave nga komuna, numri i mësimdhënësve për periudhën 2023-2024 për nivelin parafillor është 33. Për nivelin për nivelin fillor dhe të mesëm 301, për nivelin emesëm të lartë 86. Asistentë për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore 13, staf profesional administrativ dhe ndihmës 95. Gjithsej 528 mësimdhënës.

Në komunën e Kaçanikut, gjatë vitit shkollor 2022/2023 arsimin parafillor e kanë ndjekur 448 fëmijë, ndërsa në vitin 2023/2024 ky numër ka rënë në 392. Vërehet një rënie prej 12.5%. Raporti mesatar nxënës/mësimdhënës për këtë periudhë është 8 (i favorshëm krahasuar me 16 në nivel vendi).

Arsimi fillor/i mesëm i ultë: Bazuar në statistikën e ASK-së për komunën e Kaçanikut, këtë nivel arsimi në vitin shkollor 2022/2023 e kanë ndjekur 4,179 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2023/2024, 4,027 nxënës. Siç shihet ka pasur një rënie prej 3.6% nga viti në vit. Ndërsa, bazuar në të dhënat e drejtorisë së arsimit të komunës së Kaçanikut, gjatë vitit shkollor 2024/2025 kanë ndjekur mësimin 3,850 nxënës, duke shënuar një rënie tutje prej 4.4%.


⁸ Plani i veprimit në mjedis, 2025, fq. 15.

Numri i mësimdhënësve për periudhën 2023-2024 për nivelin parafillor dhe të mesëm të ultë ishte 335. Rrjedhimisht raporti mesatar nxënës/mësimdhënës për këtë periudhë është 23.2 (i pafavorshëm kundrejt mesatares 13 në nivel vendi).

Arsimi i mesëm i lartë: Këtë nivel arsimi në vitin 2022/2023 e kanë ndjekur 979 nxënës. Në vitin 2023/2024, 969 nxënës. Ka një rënie prej 1.0% nga viti në vit. Ndërsa, bazuar në të dhënat e drejtorisë së arsimit të komunës së Kaçanikut, gjatë vitit shkollor 2024/2025 kanë ndjekur mësimin 897 nxënës, duke shënuar një rënie tutje prej 7.4%.

Numri i mësimdhënësve për periudhën 2023-2024 për nivelin e mesëm të lartë ishte 84. Rrjedhimisht raporti mesatar nxënës/mësimdhënës për këtë periudhë është 11.5 (afër mesatares 12 në nivel vendi).

Graf. 9 Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare në komunën e Kaçanikut, 2019-2024



Burimi: ASKDATA: *Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2019-2024.*

Siç shihet në grafikun e mësipërm, ka rënie të numrit të nxënësve nga viti në vit për periudhën e analizuar, mesatarisht 3.0%.

Bazuar në të dhënat nga ASK (2023-2024), raporti mesatar nxënës/mësimdhënës sipas niveleve në arsimin publik është:


- Arsimi parafillor: 9.4;
- Arsimi parafillor: 16;
- Arsimi fillor/i mesëm i ultë: 13.0;

- Arsimi i mesëm i lartë: 12.

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) krijon bazën për një partneritet të qëndrueshëm ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, me synim përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet. Ajo fokusohet në zhvillimin e aftësive, zgjerimin e mundësive për punësim, nxitjen e përfshirjes sociale dhe fuqizimin e rritjes ekonomike.

Një aspekt thelbësor i MSA-së është angazhimi ndaj barazisë dhe gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor, duke adresuar veçanërisht çështjet e gjinisë, përkatësisë etnike e fetare, si dhe mbështetjen për personat me aftësi të kufizuara. Ky bashkëpunim përforcohet më tej përmes asistencës teknike nga BE për zbatimin e Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë (PSAK), duke kontribuar në transformimin e sistemit arsimor dhe garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët.

SHËNDETËSIA – Gjendja aktuale e infrastrukturës shëndetësore në komunën e Kaçanikut paraqet një nivel të kënaqshëm funksionaliteti dhe kapacitetesh. Rrjeti i objekteve shëndetësore përfshin një (1) Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), katër (4) Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe tetë (8) Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF), duke e çuar numrin total të objekteve shëndetësore në trembëdhjetë (13).



Sipas vlerësimeve të komunës, gjendja fizike e të gjitha objekteve është e mirë, duke garantuar ofrim të qëndrueshëm dhe cilësor të shërbimeve për qytetarët. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Kaçanik ka filluar punën si shtëpi e shëndetit në vitin 1956, ndërsa në vitin 2016/2017 është funksionalizuar objekti i ri i QKMF-së. Objektet e saj janë në gjendje të shkëlqyer fizike dhe ofrojnë shërbime shëndetësore për qytetarët 24 orë në ditë. Brenda QKMF-së ofrohen një sërë shërbimesh, përfshirë: ekzaminime të përgjithshme, kontrole të specializuara të brendshme, pediatri, analiza laboratorike, trajtime urgjente, rreze rëntgen dhe shërbime stomatologjike.


Sipas ASK-së, gjatë periudhës 2022–2023, Qendrat e Mjekësisë Familjare në komunën e Kaçanikut kanë pasur një numër të qëndrueshëm prej 100 të punësuarish. Prej tyre, 16 mjekë, një (1) stomatolog, 69 infermierë, një (1) farmacist dhe 13 punëtorë jo shëndetësorë.⁹

Grafiku në vijim tregon numrin e vizitave të përgjithshme në QMF në komunën e Kaçanikut në vitin 2022 dhe 2023.

Në Qendrën e Mjekësisë Familjare të Komunës së Kaçanikut, numri i përgjithshëm i vizitave mjekësore u rrit me 4.8% gjatë vitit 2023. Për sa i përket kategorive specifike, shërbimet e mjekësisë familjare shënuan një rritje të ndjeshme prej 24.3% në vitin 2023, ndërsa shërbimet e intervenimeve dhe shërbimeve tjera u zvogëluan për 11.3%. Megjithatë, laboratorët përjetuan një rritje prej 8.0%, dhe shërbimet stomatologjike shënuan një rritje prej 83.7%. Këto ndryshime pasqyrojnë tendencat dhe kërkesat e ndryshme për shërbime shëndetësore në komunë, të cilat janë analizuar më tej në grafikun përkatës.

⁹ ASKDATA: Të punësuarit në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve, 2022-2023.


Graf. 10 Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2022-2023



Burimi: ASKDATA: *Numri i vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare, 2022-2023.*

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudhën 2020–2023, komuna e Kaçanikut ka përjetuar luhatje të ndjeshme në numrin e rasteve me COVID-19. Në vitin 2020 u raportuan 306 raste të infektimi, ndërsa në vitin pasues 2021, numri u rrit me 281%, duke reflektuar përhapjen e gjerë të virusit. Viti 2022 shënoi një ulje prej 19% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në vitin 2023 u regjistrua një rënie pothuajse e plotë prej 99% të rasteve të reja, duke treguar përmirësim të dukshëm të situatës epidemiologjike dhe efektivitet të masave parandaluese.

Graf. 11 Të infektuarit me COVID-19 në komunën e Kaçanikut, 2020-2023



Burimi: ASKDATA: *Të infektuarit me COVID-19 në komunën e Kaçanikut, 2020-2023.*

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudhën 2016–2023, komuna e Kaçanikut ka pasur një mesatare vjetore prej 40 rasteve me sëmundje malinje. Krahasuar me

këtë mesatare, në vitin 2023 është shënuar një rritje e dukshme prej 123%, duke reflektuar një përkeqësim të dukshëm në indikatorët onkologjikë lokalë. Kjo tendencë kërkon vëmendje të shtuar në parandalimin, diagnostikimin e hershëm dhe përmirësimin e qasjes në shërbimet e specializuara shëndetësore.

Në vijim janë ranguar shkaqet kryesore të vdekjes në komunën e Kaçanikut, bazuar në statistikat e ASK për vitin 2020 dhe 2021.

Tab. 4 Rangimi i grupeve kryesore të shkaqeve të vdekjes në komunën e Kaçanikut, 2020-2021

Nr.	GRUPET KRYESORE TË SHKAQEVE TË VDEKJES	2020 (%)	2021 (%)
1	Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	43.6	41.1
2	Simptomat, shenjat dhe rezultatet jonormale klinike dhe laboratorike të paklasifikuara gjetiu	25.5	19.0
3	Tumoret	13.8	20.3
4	Sëmundjet e sistemit urogjenital	1.6	3.2
5	Disa gjendje me origjinë në periudhën perinatale	2.7	3.2
6	Shkaktarët e jashtëm të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë	1.1	0.0
7	Sëmundjet endokrine, të ushqyeshmerisë dhe metabolike	1.6	1.9
8	Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	9.0	8.9
9	Sëmundjet infektive dhe parazitare	0.0	1.3
10	Sëmundjet e sistemit nervor	1.1	1.3
10	Sëmundjet tjera	/	/
Gjithsej		100.0	100.0

Burimi: ASKDATA: Rangimi i 10 grupeve të shkaqeve të vdekjes sipas vendqëndrimit (komunës) në Kosovë, 2020-2021.

Siç shihet nga tabela e mësipërme, dominojnë sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, pastaj tumoret dhe sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes.

MIRËQENIA SOCIALE – është themel për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke ofruar qasje ndaj kujdesit shëndetësor, strehimit, fuqizimit ekonomik dhe mbështetjes për grupet në nevojë si të varfrit, të papunët dhe të marginalizuarit. Qëllimi i saj është të tejkalojë sigurimin e nevojave bazike dhe të krijojë mundësi për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike, duke fuqizuar qytetarët për një jetë më dinjitoze dhe të integruar.

Gjatë vitit 2023, ndihma sociale në komunën e Kaçanikut është ofruar për gjithsej 559 familje, me 2,396 anëtarë përfitues. Në vitin 2024, ky numër ka shënuar rënie, duke u ulur në 530 familje me 2,120 përfitues, gjë që reflekton një ndryshim të lehtë në përfshirje dhe mund të lidhet me faktorë socio-ekonomikë apo ndryshime në kriteret e skemës sociale.


Në kategorinë e pensionistëve invalidorë nën moshën 18 vjeç, gjatë vitit 2023 kanë përfituar 57 persona, ndërsa në vitin 2024 ky numër është rritur në 63 përfitues, duke treguar një tendencë në rritje të nevojës për mbështetje në këtë kategori. Sa i përket pensioneve për invalidët e luftës, numri i përfituesve është afërsisht 62 persona, sipas vlerësimeve aktuale.

Për familjet e dëshmorëve dhe pensionistët kontribut-pagues të moshës nuk disponohen të dhëna të sakta. Mungesa e këtyre informacionit nënvizon nevojën për një sistem të unifikuar të menaxhimit dhe raportimit të të dhënave sociale.¹⁰

Sipas të dhënave të fundit nga ASK për vitin 2020 (TM1-TM4), në komunën e Kaçanikut mesatarisht 804 familje kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale. Ndërsa, gjatë vitit 2021 (TM1-TM4), numri mesatar i familjeve përfituese u rrit në 816, që përfaqëson një rritje prej 1.6%.

TREGU I PUNËS – Në vijim janë përmbledhur disa statistika të përgjithshme mbi tregun e punës në Kosovë.

Graf. 12 Statistikat e tregut të punës, 2024, në Republikën e Kosovës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2024*, fq. 18-19.

Sipas të dhënave të vitit 2023, fuqia ekonomiksht aktive arriti në 477,350 persona, me një shkallë pjesëmarrjeje prej 40.7%, që paraqet një rritje prej 2.1% krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë, popullsia ekonomiksht joaktive ishte 694,413 persona, ose 59.3% e totalit.

Të dhënat nga ASK për të njëjtin vit tregojnë një rritje pozitive në punësim, me 425,499 të punësuar dhe një shkallë punësimi prej 36.3%, që është 2.5% më e lartë se vitin paraprak. Ndërkohë, numri i të papunëve ishte 51,851 persona, duke sjellë një shkallë papunësie prej 10.9%, që paraqet një ulje prej 1.7% në krahasim me vitin 2022.

SHËRBIMET ADMINISTRATIVE – Sipas strukturës organizative, komuna e Kaçanikut ka gjithsej nëntë (9) drejtori, të cilat janë prezantuar detajisht te skema organizative e komunës (*shih shtojcën nr. 2*).

Komuna është përgjegjëse kryesisht për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve primare ndaj qytetarëve, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale - Ligji Nr. 03/L-040. Si rezultat, komuna e

¹⁰ Të dhënat nga drejtoria përkatëse e komunës së Kaçanikut.

Kaçanikut i ofron të gjitha shërbimet dhe merr përgjegjësitë e përcaktuara nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

Tab. 5 Numri i të punësuarve në komunës e Kaçanikut, sipas drejtorive

Nr.	Të punësuarit sipas drejtorive në komunë	
1	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme	25
2	Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	3
3	Drejtorja e Arsimit	6
4	Drejtorja e Buxhetit dhe Financave	10
5	Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	12
6	Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	8
7	Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë	4
8	Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	16
9	Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizimit	3
10	Zyra e Kuvendit Komunal	27
11	Zyra e Kryetarit	25
Gjithsej		139

Burimi: *Të dhënat nga komuna.*

INFRASTRUKTURA – Infrastruktura rrugore në Kaçanik është e ndërlidhur ngushtë me rrjetin qendror të transportit të Kosovës, duke përfshirë Autoudhën (R6) Prishtinë - Hani i Elezit dhe rrugën nacionale (N2) në të njëjtën drejtim. Autoudha (R6) e përshkon territorin e komunës në vijën veri-jug, duke filluar në Ultësirën e Kosovës në veri dhe vazhduar nëpër luginën e Lepencit dhe Grykën e Kaçanikut në jug, me një gjatësi prej afër 17.3 km. Kjo përfshirje bën që komuna të jetë pjesë e korridoreve me rëndësi ndërshtetërore dhe regjionale. Në nivel ndërkombëtar, kjo autoudhë mundëson lidhje të shpejtë me korridorin VIII (porti i Durrësit) dhe korridorin X në veri. Lidhja direkte me autoudhën mundësohet përmes hyrje/daljes në territorin e fshatit Doganaj, në zonën e njohur si Fusha e Pajtimit.

Rruga nacionale (N2) Prishtinë - Hani i Elezit shtrihet paralelisht me autoudhën, me një gjatësi prej afër 16.7 km në territorin e Kaçanikut. Ajo mundëson lidhje me Ferizajn, Vitinë, Hanin e Elezit, Shtërpçën dhe Prizrenin përmes Maleve të Sharrit. Profili përbëhet prej dy shiritave me nga 3.5 metra dhe gjendja fizike e saj vlerësohet si e mirë, megjithëse trafiku është i ngarkuar dhe zhvillimi i vendbanimeve përgjatë trasesë paraqet sfida për sigurinë.

Rrjeti plotësohet edhe nga tri rrugë rajonale - R116 (Doganaj-Gllboçicë), R115 (Doganaj-Prizren) dhe R112 (Gërllicë-Begracë-Viti), të cilat e bëjnë qarkullimin më të lehtë dhe më të gjerë në rajon. Këto rrugë mirëmbahen nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.


Në nivel lokal, komuna ka investuar dukshëm në zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit rrugor. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor lokal është 263.7 km, prej të cilave 101.27 km janë të asfaltuara (38.46%), 5.7% me pllaka ndërlidhëse dhe pjesa tjetër me zhavorr apo baltë. Sot, rrjeti rrugor lokal ka një gjatësi prej 332.37 km, prej të cilave 272.89 km janë të asfaltuara, që përfaqësojnë 82.10% të totalit. Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare është 19.82%¹¹,

¹¹ <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/Kacanik.pdf>

duke bërë që përmirësimi i infrastrukturës për këmbësorë të mbetet një çështje që kërkon vëmendje të veçantë. Në kuadër të rrjetit rrugor janë mbi 20 ura me një gjatësi totale prej 300 m, të gjitha të ndërtuara nga betoni. Megjithëse të kalueshme për automjete, shumë prej tyre nuk i plotësojnë standardet e ndërtimit dhe janë të ngushta për trafik dykahor dhe lëvizje të sigurt të këmbësorëve.


Në qytetin e Kaçanikut, tre rrugë kryesore gjatësore shtrihen paralelisht me lumin Nerodime, duke përkrahur qendrën në drejtimin veri-jug. Ato janë të lidhura me rrugë tërthore si dhe me linjën që e bashkon qytetin me rrugën nacionale. Rrugët tjera të lagjeve urbane funksionojnë si linja radiale ndaj të parave. Rruga përgjatë lumit Nerodime dhe ajo që shpie drejt rrugës nacionale kanë trotuare të gjera dhe funksionale, ndërsa rrugët tjera vuajnë nga ngushtësia apo mungesa e trotuareve. Në periudha të caktuara, veçanërisht gjatë verës, shfaqen ngarkesa në arteriet kryesore që pengojnë qarkullimin e rrjedhshëm dhe ndikojnë negativisht në jetën urbane. Rrjeti sekondar brenda lagjeve është i zhvilluar në formë të lirë, shpesh me rrugë qorre si pasojë e zhvillimeve të paplanifikuara.

Rrugët rurale janë përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit. Përfundim bëjnë vendbanimet Nikoc, Drenogllavë dhe Korbliq, ku rrugët kanë nevojë për rregullim dhe shtrim. Vendbanime të tjera si Doganaj, Dubrava, Begraca, Kaçaniku i Vjetër, Bobi, Biçeci, Gllaboçica, Kovaqeci dhe Shtraza (duke përfshirë rrugën Kaçanik–Doganaj) kanë trotuare funksionale në pjesët kryesore, duke mundur lëvizje të sigurt për këmbësorët. Në vendbanimet me numër më të ulët të banorëve, qarkullimi për këmbësorë shpesh realizohet nëpër rrugë pa trotuare dhe me lidhje të dobëta. Edhe pse komuna ka ndërtuar rreth 38.73 km trotuare dhe nënkalime, ende ka mungesa të theksuara, veçanërisht në lidhjet nga lagjet drejt shkollave dhe nga zonat rurale drejt qytetit.¹²



¹² Plani lokal i veprimtimit në mjedis, 2012/2017 dhe Draft- plani zhvillimor komunal i Kaçanikut 2023-2031, fq. 67-69.

Graf. 13 Rrjeta e rrugëve në komunën e Kaçanikut



Burimi: Përpunuar nga *Plani lokal i veprimit në mjedis, 2012/2017* dhe *Draft-plani zhvillimor komunal i Kaçanikut 2023-2031*, fq. 67-69.

Rrjeti hekurudhor: Infrastruktura hekurudhore, si pjesë e linjës nacionale Fushë Kosovë - Shkup, është gjithashtu e pranishme dhe në proces përmirësimi, me synimin që të ofrojë kushte më të mira për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave.¹³

Transporti: Shërbimi publik i transportit në Kaçanik përballlet me kufizime të theksuara, sidomos sa i përket infrastrukturës dhe organizimit të tij. Aktualisht, ekziston vetëm një stacion autobusi në zonën urbane, ndërsa fshatrat e mëdhenj në pjesën veriore të komunës kanë të rregulluara vetëm vend-ndalje për autobusët. Kjo situatë kufizon qasjen e banorëve të zonave rurale në shërbime të strukturuar dhe të standardizuara transporti.

Transporti në Kaçanik ofrohet kryesisht nga sektori privat përmes autobusëve, minibusëve dhe taksive. Lidhjet ndër-komunale përfshijnë linjat Kaçanik–Ferizaj (me 29 qarkullime në ditë), Kaçanik–Prishtinë (3 herë në ditë) dhe Kaçanik–Hani i Elezit (10 herë në ditë). Linja e udhëtimit drejt Prishtinës është veçanërisht problematike, pasi kalon përmes Ferizajt dhe zgjat deri në dy orë, duke ndikuar negativisht në efikasitetin e transportit për udhëtarët e kësaj rruge.

Në nivel komunal, transporti publik funksionon për 12 vendbanime të mëdha, me një mesatare prej pesë qarkullimesh në ditë për shkuarje dhe kthim. Për shkak të sipërfaqes relativisht të vogël të zonës urbane, nuk është konsideruar e arsyeshme të ofrohet transport publik i brendshëm për qytetin. Megjithatë, shërbimi aktual i autobusëve ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme në aspektin e cilësisë, besueshmërisë, frekuencës së linjave dhe komoditetit për përdoruesit.

Transporti jo-motorik, sidomos përdorimi i biçikletave, është shumë i kufizuar. Nuk ekzistojnë shtigje të dedikuara apo parkingje të organizuara për biçikleta, duke e bërë këtë mënyrë

¹³ Plani i veprimit në mjedis, 2025, fq. 15.

ekologjike të transportit të vështirë për t'u përdorur në mënyrë të përhershme dhe të sigurt. Kjo mungesë e infrastrukturës ndikon në shfrytëzimin minimal të mjeteve alternative dhe jo ndotëse të transportit.

Menaxhimi i transportit dhe infrastrukturës përkatëse i organizuar nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (DSHPE) përballet me vështirësi të mëdha për shkak të kapaciteteve të kufizuara. Sfida më e madhe mbetet menaxhimi i lëvizshmërisë multi-modale, veçanërisht në zonën urbane dhe në grupin e fshatrave të mëdhenj në veri, si dhe integrimi i formave alternative dhe jo-motorike të lëvizjes në të gjitha fazat e planifikimit dhe zbatimit të politikave të mobilitetit.¹⁴

TELEKOMUNIKACIONI - Telekomunikacioni në Kaçanik është i mbuluar nga disa operatorë kryesorë, përfshirë Ipko, Kujtesa, Telkos dhe Telekomin e Kosovës, të cilët ofrojnë shërbime të internetit dhe televizionit kabllor në pjesën më të madhe të zonave urbane dhe rurale. Megjithatë, fshatrat Nikoc, Drenogllavë, Korbliq dhe Gjurgjedell mbeten jashtë mbulimit të këtyre shërbimeve, duke reflektuar nevojën për zgjerim të infrastrukturës digjitale në këto zona. Sa i përket telefonisë mobile, mbulimi është i plotë në të gjitha vendbanimet e komunës, falë rrjetit të operatorëve Vala dhe Ipko, të cilët sigurojnë qasje të qëndrueshme në komunikim përmes rrjeteve celulare.¹⁵

RRJETI ENERGJETIK - Sigurimi i energjisë elektrike në komunën e Kaçanikut realizohet përmes një sistemi të përbashkët me komunat fqinje. Njësia lokale e KEDS mbulon 26 vendbanime, ndërsa gjashtë (6) të tjera furnizohen nga njësitë punuese të komunave përreth. Infrastruktura për transformimin e tensionit përfshin dy transformatorë 35/10 kV në nënstacionin e Kaçanikut, dy të tjerë në nënstacionin e Silcaporit, si dhe dy transformatorë 35/0.4 kV për tension më të ulët. Brenda territorit komunal funksionojnë gjithashtu 165 transformatorë të vegjël me kapacitet 10(20)/0.4 kV, të cilët sigurojnë shpërndarjen e energjisë në nivel lokal.

Sa i përket prodhimit të energjisë elektrike, Kaçaniku ka disa hidrocentrale aktive dhe të planifikuara. Hidrocentrali Lepenci 3, me kapacitet prej 9.9 MW, është përfunduar dhe ndodhet në Sllatinë. Hidrocentrali Saponica, me kapacitet prej 1.3 MW, është aktualisht në ndërtim. Ndërkohë, hidrocentrali Lepenci 1 dhe hidrocentrali Kotlina kishin qenë të planifikuar për ndërtim, por lejet dhe autorizimet e tyre kanë skaduar, dhe rekomandohet që të mos lejohen të ndërtohen. Përfitimi i energjisë nga burime alternative, kryesisht solare, është shumë i kufizuar dhe i pranishëm vetëm në disa objekte private.

Konsumi i energjisë elektrike në Kaçanik varion nga 8 MWh gjatë verës deri në 11 MWh në dimër. Edhe pse banorët e Kaçanikut përbëjnë rreth 2% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës, ata konsumojnë vetëm 0.85% të energjisë elektrike në dimër, krahasuar me konsumin total prej 1300 MWh në nivel nacional. Ky disproporcion tregon për një standard më të ulët jetese dhe një nivel të ulët të zhvillimit socio-ekonomik në komunë.

¹⁴ Plani i veprimit në mjedis, 2025, fq. 20.

¹⁵ Po aty, fq. 19.

NDRIÇIMI PUBLIK - Ndriçimi publik në komunën e Kaçanikut paraqet një nga aspektet më të avancuara të infrastrukturës komunale në krahasim me sektorët e tjerë të efijencës energjetike. Komuna ka ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e ndriçimit rrugor dhe urban, duke instaluar pajisje moderne me konsum të ulët energjie, siç janë llambat LED. Kjo ka ndikuar pozitivisht në uljen e shpenzimeve për energji elektrike dhe në rritjen e sigurisë për qytetarët gjatë orëve të natës. Ndriçimi publik mbulon zonat kryesore të qytetit dhe po zgjerohet gradualisht edhe në lagjet periferike, në përputhje me planin zhvillimor të komunës. Përmes këtyre investimeve, Kaçaniku synon të krijojë një ambient më të ndriçuar, më të sigurt dhe më të qëndrueshëm për banorët e vet.



FURNIZIMI ME UJË - Qyteti i Kaçanikut dhe 26 vendbanimet rurale përreth furnizohen me ujë të pijshëm kryesisht nga sisteme të përbashkëta ujësjellësi. Prej tyre, 18 vendbanime menaxhohen nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) “Bifurkacioni”, Njësia në Kaçanik, ndërsa dhjetë vendbanime kanë sisteme që menaxhohen nga vetë banorët. Pesë vendbanime të tjera nuk kanë sistem të organizuar ujësjellësi dhe mbështeten në furnizime familjare përmes puseve ose burimeve natyrore joformale.

Në total, përmes rrjetit të ujësjellësit me gjatësi prej 69,117 metrash, furnizohen 6,772 ekonomi familjare dhe 1,143 konsumatorë të tjerë, përfshirë biznese të vogla e të mëdha, industri dhe institucione publike. Megjithatë, ofrimi i shërbimit përballet me sfida të shumta, ku më seriozet janë pamundësia për furnizim të pandërprerë 24 orë, veçanërisht gjatë verës së vonshme dhe vjeshtës, si dhe niveli i lartë i ujit të pa-faturuar. Në vitin 2018, KRU “Bifurkacioni” raportoi se nga rreth 9 milion m³ ujë të futur në sistem, 5.6 milion m³ (62%) nuk ishin të faturuara. Ky ujë përfshin humbjet në sistem dhe një pjesë të konsumit të autorizuar që, për arsye të ndryshme, nuk faturohet, si rezultat i keqmenaxhimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së ujit.¹⁶

Tab. 6 Vendbanimet sipas mënyrës së furnizimit me ujë

Nr.	KLASIFIKIMI I VENDBANIMEVE	VENDBANIMET	NUMRI
1	Vendbanime me sisteme ujësjellësi që menaxhohen nga KRU “Bifurkacioni”, njësia në Kaçanik	Kaçanik, Bëgracë, Doganaj, Kaçanik i Vjetër, Dubravë, Bob, Shtrazë, Runjevë, Nikaj, Rekë, Soponicë, Koxhaj, Elezaj, Sllatinë, Gllloboçicë, Stagovë dhe Shtrazë	18
2	Vendbanime me sisteme ujësjellësi që menaxhohen nga vet banorët	Biçec, Kovaçec, Semajë, Bajnicë, Duraj, Gabrricë, Gërllicë e Epërme, Kotlinë, Gajre, Ivajë	10
3	Vendbanime pa sistem të përbashkët ujësjellësi (furnizime familjare nga puset dhe jo formalisht nga burimet natyrore)	Disa lagje periurbane, Korbliq, Drenogllavë, Nikoc, Llanishtë, Gjurgjedell	5
Gjithsej			33

Burimi: *Plani i veprimt në mjedis, 2025*, fq. 18.

¹⁶ Plani i veprimt në mjedis, 2025, fq. 18.

KANALIZIMI - Sa i përket kanalizimit, mbulueshmëria në komunën e Kaçanikut arrin në rreth 95% të popullsisë, përmes një rrjeti me gjatësi prej 95,380 metrash. Ashtu si me ujësjellësin, disa fshatra nuk kanë sistem të kanalizimit të ndërtuar. Infrastruktura ekzistuese është e organizuar në sisteme të ndara për secilin vendbanim ose për grupe të caktuara vendbanimesh. Në 21 nga 24 fshatra, sistemet e kanalizimit menaxhohen nga KRU “Bifurkacioni”.

Sistemi për kanalizimin e ujërave atmosferikë është i pranishëm në disa pjesë të zonës urbane, kryesisht në rrugët kryesore dhe në disa fshatra të mëdha, ku paraqitet si kanale të mbyllura. Në rrugët lokale që lidhin vendbanimet, ky sistem paraqitet si kanale të hapura. Në mungesë të infrastrukturës adekuate, në disa raste uji atmosferik përziehet me ujërat e zeza, duke krijuar probleme të ndërlikuara për mjedisin dhe shëndetin publik.¹⁷

MBETURINAT - Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në komunën e Kaçanikut realizohet nga dy operatorë: Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastërtia” dhe ndërmarrja private NP “Krasniqi”. Të dy operatorët angazhojnë gjithsej 38 punonjës, përfshirë staf teknik dhe administrativ, të cilët janë përgjegjës për ofrimin e shërbimit në territorin e komunës.

Gjatë vitit 2025, nga gjithsej 5,547 ekonomi familjare sa kishte Kaçaniku, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave u ofrua për 5,270 prej tyre, të shpërndara në 27 nga 32 vendbanime. Kjo përfaqëson një mbulim prej 95% të ekonomive familjare dhe 98% të vendbanimeve. Megjithatë, jo në të gjitha vendbanimet e shërbyera ofrohet shërbimi për çdo ekonomi familjare, duke lënë hapësirë për përmirësim të mbulimit të plotë.

Në anën tjetër, shërbimi mbulon të gjitha bizneset aktive në komunë, që janë gjithsej 306, si dhe 35 entitete publike dhe organizata të tjera. Kjo tregon një përfshirje të plotë të sektorit ekonomik dhe institucional në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Të dy operatorët e shërbimit disponojnë gjithsej 12 kompaktorë (kamionë për mbeturina) me kapacitete të ndryshme, përmes të cilëve grumbullohen rreth 5,705 ton mbeturina në vit. Ky kapacitet teknik mundëson një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve urbane në komunë.

Sa i përket aspektit financiar, faturimi realizohet për 100% të klientëve, ndërsa niveli i arkëtimit arrin në 90.7%. Ky tregues dëshmon për një sistem efikas të mbledhjes së të ardhurave dhe një nivel të lartë të përgjegjësisë qytetare

Të gjitha llojet e mbeturinave të grumbulluara deponohen në deponitë sanitare rajonale, konkretisht në Velekincë (Gjilan) dhe Mirash (Fushë Kosovë). Kjo siguron trajtim të kontrolluar dhe të sigurt të mbetjeve, në përputhje me standardet mjedisore dhe sanitare të vendit.¹⁸

KULTURA – Trashëgimia kulturore në komunën e Kaçanikut përfaqëson një pasuri të rrallë me vlera historike, arkitektonike dhe etnografike, që mund të shndërrohet në një shtyllë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe turistik. Institucionet lokale kanë ndërmarrë hapa domethënës në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të këtyre vlerave, duke themeluar Zyrën e

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (2023-2027).

Trashëgimisë Kulturore brenda DKRS-së dhe hapur Muzeun e Qytetit. Këto veprime përbëjnë bazën për një qasje më të strukturuar ndaj ruajtjes së identitetit kulturor të komunës.

Një prej sfidave kryesore për këtë sektor mbetet përfshirja e pamjaftueshme e komunitetit lokal dhe mungesa e OJQ-ve që fokusohen në trashëgiminë kulturore. Kjo pengon zhvillimin e projekteve kreative dhe kufizon qasjen në fondet ndërkombëtare. Krijimi dhe fuqizimi i organizatave joqeveritare me fokus në kulturë është thelbësor për të rritur ndërgjegjësimin qytetar, për të nxitur pjesëmarrjen aktive të banorëve dhe për të zgjeruar mundësitë për bashkëpunim institucional dhe financiar me aktorë të jashtëm.

Nëse trajtohet me një strategji të qëndrueshme dhe shumëplanëshe, trashëgimia kulturore mund të luajë rol funksional në gjallërimin e turizmit lokal. Komuna e Kaçanikut ofron një sërë vendndodhjesh me interes historik e arkitektonik si dhe vlera të trashëgimisë shpirtërore që mund të përfshihen në itinerare kulturore apo ndërdisiplinare (natyrë-kulturë). Këto burime, kur integrohen në një planifikim institucional të strukturuar dhe të mbështetur nga sektorë të ndryshëm, krijojnë vlerë të shtuar për zhvillimin ekonomik lokal dhe diversifikimin e burimeve të të ardhurave.

Trashëgimia kulturore e Kaçanikut është pjesë e Qendrës Regjionale për Trashëgimi Kulturore, së bashku me Komunën e Ferizajt, duke ofruar një platformë për bashkëpunim rajonal dhe mbështetje profesionale. Kjo ndërlidhje hap rrugën për planifikim më të gjerë dhe të koordinuar, duke e pozicionuar trashëgiminë kulturore si element strategjik në kuadër të zhvillimit ekonomik afatgjatë të komunës.¹⁹

Trashëgimia kulturore në Kaçanik karakterizohet nga një diversitet i pasur që përfshin monumete të arkitekturës, lokalitete arkeologjike, peizazhe me vlera kulturore dhe një zonë të mbrojtur me status të veçantë. Në total, janë identifikuar 67 objekte dhe tërësi që përbëjnë mozaikun e trashëgimisë kulturore në këtë komunë.

Xhamia e Sinan Pashës në Kaçanik, e ndërtuar në vitin 1594 dhe e restauruar së fundi në 2012-2013, përfaqëson një prej monumenteve më të rëndësishme të trashëgimisë arkitekturore në Kosovë. Me numër referimi 3172, kjo xhami është zyrtarisht e përfshirë në listën e mbrojtjes së përhershme, si dëshmi e vlerave të saj historike, kulturore dhe shpirtërore. Stili klasik osman, minarja karakteristike dhe funksioni i saj si qendër shpirtërore e komunitetit e bëjnë këtë objekt një gur themeli në identitetin kulturor të Kaçanikut dhe një pasuri kombëtare që duhet ruajtur me kujdes.

Brenda kësaj trashëgimie, 19 objekte i takojnë kategorisë së trashëgimisë arkitektonike. Një prej tyre daton nga shekulli XV dhe përfaqëson një element të rrallë të ndërtimit historik, ndërsa objektet e tjera janë ndërtuar gjatë shekujve XIX dhe XX, duke reflektuar zhvillimin e arkitekturës tradicionale dhe urbane në rajon.²⁰

¹⁹ Të dhëna nga komuna e Kaçanikut.

²⁰ Plani i veprimtimit në mjedis, 2025, fq. 16.

Tab. 7 Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2025), trashëgimia arkitekturore

Nr.	EMRI	PERIUDHA	VENDI	NUMRI
1	Tyrbja e Musa Kesexhisë	Shek. XX	Kaçanik	3172
2	Salla e shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut	1991	Kaçanik	4158
3	Shkolla e vjetër në Kaçanik	1936	Kaçanik	4159
4	Shtëpia e Shaip Hysajt në Stagovë	1936	Stagovë, Kaçanik	1092
5	Xhamia në Begracë	Shek. XX	Begracë, Kaçanik	152
6	Oda e Familjës Luzha në Begrace	1830-1840	Begracë, Kaçanik	821
7	Xhamia në Gllaboçicë	1895	Gllaboçicë, Kaçanik	171
8	Shtëpia e Enver Lumës	1830	Gllaboçicë, Kaçanik	4153
9	Shtëpia e Minah Lumës	1920	Gllaboçicë, Kaçanik	4155
10	Xhamia në Gurëzi (Shtrazë)	Shek. XIX	Gurëzi (Shtrazë), Kaçanik	163
11	Xhamia në Kurbali (Korbliq)	Shek. XIX	Korbliq, Kaçanik	3568
12	Bujtina "Hanxhik" e Kadrie Berishës	1930	Runjevë, Kaçanik	4152
13	Mulliri i fshatit Biçec	1910	Biçec, Kaçanik	4156
14	Shtëpia e Rrahim Rizah Rekës	1910 - 1920	Korbliq, Kaçanik	4157
15	Shtëpia - kullë e Halit Selmanit – Stagovë	Shek. XIX	Stagovë, Kaçanik	1067
16	Shtëpia - kullë e Xhemajl Brahës - Kaçanik	Shek XIX	Stagovë, Kaçanik	1070
17	Kulla e Hasanit – Kulla e Rambujesë	Shek XIX	Bob, Kaçanik	4893
19	Shtëpia e Agim Luzhës	Shek XIX	Begracë, Kaçanik	4894

Burimi: *Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2025)*. https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/5360_2_2.pdf.

Në kuadër të trashëgimisë arkeologjike të komunës së Kaçanikut janë evidentuar katër lokalitete/rezervate me rëndësi historike, të cilat janë pjesë e listës zyrtare 2025 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Këto lokalitete përfaqësojnë dëshmi të rëndësishme të zhvillimit shoqëror dhe kulturor përgjatë periudhave të ndryshme historike në rajon. Ato përfshijnë vendbanime të lashta, struktura mbetëse dhe gjetje arkeologjike që ndihmojnë në dokumentimin e identitetit lokal dhe trashëgimisë së hershme të popullsisë së zonës.

Tab. 8 Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2025), trashëgimia arkeologjike

Nr.	EMRI	PERIUDHA	VENDI	NUMRI
1	Kalaja e Kaçanikut	Antike, Antikiteti i Vonë, Mesjetë	Kaçanik	143
2	Lokaliteti arkeologjik të kisha në Bob**	Antikiteti i Vone	Bob, Kaçanik	643
3	Kalaja e Llanishtës	Antikiteti i Vonë	Llanishtë, Kaçanik	645
4	Rrënojat në oborrin e ndërtesës së Kuvendit Komunal të Kaçanikut	Osmane, Mesjetare	Kaçanik	4946

Burimi: *Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2025)*. https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/5360_2_2.pdf.

Xhamia e Koxha Sinan Pashës: Xhamia e Koxha Sinan Pashës në Kaçanik është një monument i trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë historike dhe arkitekturore për Kosovën. E ndërtuar në vitin 1594–1595 nga Sinan Pasha Topojani, një figurë e shquar e Perandorisë Osmane që ka shërbyer si vezir i madh pesë herë, kjo xhami përfaqëson stilin klasik osman me një minare të vetme dhe strukturë të ndërtuar nga gurë të terrenit. Ajo ndodhet në qendër të Kaçanikut, pranë kalasë së vjetër, dhe është pjesë e kompleksit historik që përfshin edhe fortifikimin e qytetit.

Xhamia është e përfshirë në listën e mbrojtjes së përhershme të trashëgimisë kulturore të Kosovës, me numër referimi 3172, siç dokumentohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor.

Ky status është dhënë për shkak të vlerave të saj arkitekturore, shpirtërore dhe historike, duke e bërë një pikë referimi të rëndësishme për identitetin kulturor të Kaçanikut dhe më gjerë.

Fig. 5 Xhamia e Koxha Sinan Pashës



Burimi: Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit.

Kalaja e Llanishtës: Fortesa në Vranjak, e vendosur rreth 1 km në jug të Kaçanikut, në një lartësi prej 684 metrash mbi nivelin e detit, paraqet një strukturë të lashtë fortifikuese me vlera të rëndësishme historike dhe arkitekturore. Rrënojat e saj dëshmojnë për një mur mbrojtës të ndërtuar me gurë të papërpunuar të lidhur me llaç gëlqeror, me trashësi rreth 1.7 metra dhe lartësi të ruajtur prej 2.5-3 metra, të vendosur mbi shkëmbin natyror. Në pjesën më të lartë të kodrës, ky mur ruan një gjatësi prej 50-60 metrash, duke ndjekur linjat natyrore të relievit (izohipsat). Përmes një qafe të butë, kjo fortifikatë lidhet me fshatin Llanishtë, duke treguar funksionin e saj strategjik në komunikimin mes zonave kodrinore dhe atyre të banuara.²¹

²¹ <https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageId=2198>

Fig. 6 Kalaja e Llanishtës



Burimi: <https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageld=2198> (qasur për herë të fundit më 03.08.2025).

Në vitin 2025 janë propozuar: Shtëpia dëshmorit-hero Avdyl Gafurr Luma - Gllloboqicë, parcela 01072-0, Gllloboqicë, kulla e Nikës - Nikaj, parcela 00672-2, Nikaj, shtëpia e Rrustem Shaqir Kukës – Lagjja Kukaj-Bob, Komuna e Kaçanikut, parcela 00073-0, Kukaj, shtëpia Muze e Dëshmorit-hero Ismail Raka, parcela 01542-0 dhe stani i Remzi Demës – Fshati Bob, parcela 00666-3, Komuna e Kaçanikut.

Në komunën e Kaçanikut, sektori i kulturës, rinisë dhe sportit përfaqëson një komponent të rëndësishëm të zhvillimit lokal, duke ndikuar drejtpërdrejt në përfshirjen e komunitetit dhe ngritjen e mirëqenies sociale. Në komunë veprojnë shtatë organizata joqeveritare rinore aktive, përfshirë KVRL, BONEVET, HANDIKOS, DISCOVERY LAB, Kampin e Artistëve Mural, Qendrën Rinore “Shtëpia e Shpresës” dhe Rininë e Kryqit të Kuq. Këto organizata angazhohen në iniciativa për fuqizimin e të rinjve, edukimin joformal, artin dhe integrimin social.

Gjatë vitit 2024, në shtëpinë e kulturës janë mbajtur gjithsej 12 shfaqje dhe performanca artistike, përfshirë tri ngjarje tradicionale si “*Festivali i Shoqërive dhe Ansambleve Kulturo Artistike*”, “*Festivali i Këngëve Popullore për Fëmijë*” dhe “*Java e Diasporës*”. Këtyre u shtohen aktivitete të tjera si *Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve* (1 Qershori), *Dita e Tokës* (22 Prilli), *Dita e Librit* (23 Prilli), *Dita e Dëshmorëve* (10 Gushti), *Festat e Nëntorit*, *Dita e të Moshuarve* (1 Tetori), *Java e Rinisë* dhe aktivitete për *Ditën e Personave me Aftësi të Kufizuara* (3 Dhjetori).

Veçanërisht, bashkëpunimi me organizata vendore dhe ndërkombëtare ka sjellë përmbajtje të re artistike e edukative në programin vjetor të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.²²

Sektori i sportit gjithashtu ka një prani dinamike në komunë. Palestra komunale e sportit është funksionale dhe përdoret gjerësisht për garat sportive të klubeve, veprimtari shkollore dhe aktivitete komunale. Palestra shoqërohet edhe me poligonin sportiv të terreneve të jashtme, si fusha me bar sintetik për futboll të vogël, fusha e tenisit dhe fushën e basketbollit, hendbollit dhe futsallit, që ofrojnë mundësi të gjera për zhvillimin e sportit masiv në Kaçanik.

Kjo infrastrukturë plotësohet edhe nga pesë palestra sportive të shkollave fillore dhe të mesme, të cilat janë të hapura për përdorim pas përfundimit të orarit mësimor, si dhe nga pesë fusha private për futsal me bar sintetik, të shpërndara në zona të ndryshme të komunës. Stadiumi i Qytetit “Besnik Begunca” është funksional, mirëpo është projekt ende i papërfunduar. Ai përfshin edhe hapësira të tjera për ndërtimin e fushave ndihmëse dhe dhomat e zhveshjes, duke krijuar kushte të përshtatshme për organizimin e ndeshjeve dhe aktiviteteve sportive.

Megjithatë, projekti i stadiumit “Besnik Begunca” nuk është përfunduar tërësisht, pasi pjesa e tribunave dhe punimet përfundimtare janë ende në proces e sipër. Në këto hapësira sportive zhvillojnë aktivitetet e tyre klubet sportive dhe shkollat sportive të komunës, përfshirë: Klubi i Futbollit “Lepenci”, Klubi i Futbollit të Femrave “Bazelli 2015”, Klubi i Basketbollit “Kaçaniku”, seniorët dhe gjenerata U18, Klubi i Basketbollit “Lepenci”, Gjenerata U16 dhe kategoritë më të reja meshkuj dhe femra, Klubi i Volejbollit për Femra “Kaçaniku”, Klubi i Volejbollit për Meshkuj “Kaçaniku”, Klubi i Mundjes “Kaçaniku”, Klubi i Pingpongut “Kaçaniku”, Klubi i Shahut “Lepenci”, Klubi i Hendbollit “Lepenci”, Shoqata e Sportit Shkollor në Kaçanik, Motokros “Kaçaniku”, Klubi i Taekëondo “Kaçaniku”, Shoqata e Bjeshkatarëve Alpinistë “Kaçaniku 2015”, Shoqata e Peshkatarëve Sportiv dhe Rekreativ “Trofta e Lepencit”, Klubi i Motoçiklizmit “Enduro Kaçaniku”, Klubi Snooker “7 Shtatori”, Shkolla e Futbollit “Talenti”, Shkolla e Futbollit “New Star”, Shkolla e Futbollit “Almati”, Shkolla e Futbollit “Avdurri”, Shkolla e Futbollit “Bazelli”.

Këto organizata luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e sportit dhe angazhimin e të rinjve në aktivitete fizike dhe komunitare, e që mbulojnë një gamë të larmishme disiplinash, nga futboli dhe basketbolli deri te taekëondo, motokros, volejboli dhe peshkimi sportiv.

Megjithatë, ky sektor përballlet me disa sfida të konsiderueshme. Mungesa e infrastrukturës sportive të plotë, financimi i pamjaftueshëm për kalimin nga sporti amator në atë profesional, përfshirja e kufizuar e vajzave në sport dhe mungesa e stafit të kualifikuar brenda klubeve përbëjnë disa nga vështirësitë kryesore. Një tjetër problem është përfundimi i ngadalshëm i projekteve kapitale si stadiumi “Besnik Begunca” dhe ndërtimi i zgjatur i palestrës sportive.

Në përgjithësi, sektori është aktiv dhe kontribuon në promovimin e vlerave kulturore e sportive, por përballja me mungesën e financimeve të qëndrueshme, infrastrukturën e amortizuar, kërkon ndërhyrje strategjike. Prioritetet afatshkurtra dhe afatgjata përfshijnë rritjen e investimeve publike dhe private, përmirësimin e infrastrukturës, motivimin dhe përfshirjen e

²² Të dhëna nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

rinisë në aktivitete, si dhe krijimin e partneriteteve të reja për të avancuar sektorin drejt një zhvillimi gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm.²³

Sipas të dhënave nga ASK, numri i lexuesve në bibliotekën e qytetit gjatë vitit 2020 ishte 344, ndërsa gjatë vitit 2021, 418. Biblioteka në vitin 2020 kishte 23,064 tituj, ndërsa në vitin 2021, 24,547 tituj.

PROFILI EKONOMIK I KOMUNËS SË KAÇANIKUT – Komuna e Kaçanikut, e vendosur në juglindje të Republikës së Kosovës, përballlet me sfida të shumta në fushën e zhvillimit ekonomik. Ekonomia lokale mbetet ende e pazhvilluar, e cila ka pësuar goditje të shumta si pasojë e tranzicioneve pasluftës, transformimeve strukturore dhe mungesës së investimeve afatgjata. Privatizimi i ndërmarrjeve publike ka çuar në zvogëlimin e vendeve të punës, ndërkohë që themelimi i komunës së Hanit të Elezit ka reduktuar pronën publike të Kaçanikut, duke dobësuar potencialin e saj institucional dhe ekonomik.

Një ndër faktorët më të ndjeshëm ishte shkëputja territoriale e fabrikës “Sharr Cem”, dikur një shtyllë e fuqishme industriale, që ka zhvendosur operimin jashtë Kaçanikut dhe ka zëvendësuar stafin me banorë nga komuna ku tashmë operon. Kjo ka çuar në një rritje të konsiderueshme të papunësisë në komunë dhe ka reduktuar ndjeshëm përfitimet lokale nga ky aktivitet ekonomik. Gjendja e rënduar e ekonomisë pas luftës është reflektuar edhe në infrastrukturën e dëmtuar, e cila vetëm pasluftës ka nisur të përmirësohet në mënyrë të moderuar.

Tradicionalisht, ekonomia lokale është mbështetur në sektorin ndërtimor, por komuna ka potenciale të mëdha të pashfrytëzuara në fusha si bujqësia, bletaria, pemëtaria, zanatet tradicionale dhe turizmi sezonal. Veçanërisht përpunimi artizanal i drurit, gërryerja e gurit dhe rrobaqepësia kanë trashëgimi të pasur në këtë komunë, që mund të rigjallërohen nëse mbështeten me politika zhvillimore të mirëstrukturuara.

Megjithëse Kaçaniku ka përfituar investime kapitale nga niveli qendror, mungesa e qasjes së balancuar rajonale vazhdon të jetë pengesë serioze. Komunat më të vogla si Kaçaniku shpesh anashkalohen në projekte strategjike për shkak të ndikimeve politike dhe numrit më të vogël të banorëve, gjë që ndikon në përfaqësimin e tyre të kufizuar në vendimmarrje ekzekutive dhe legislative. Ky sistem disfavorizues ka sjellë një zhvillim të pabarabartë mes qendrave rajonale dhe periferike.

Buxheti komunal i pamjaftueshëm ka qenë gjithashtu një faktor pengues për zhvillimin e hovshëm të ekonomisë lokale. Autoritetet lokale kanë qenë të detyruara të përqendrohen në projekte infrastrukturore bazike, si ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve, kanalizimet fekale dhe atmosferike, ndërtimi i objekteve arsimore dhe shëndetësore, si dhe mirëmbajtja e tyre. Ky fokus megjithatë, ka kufizuar mundësitë për nxitjen e iniciativave ekonomike inovative dhe zgjerimin e sektorëve më dinamikë.²⁴

Megjithatë, Kaçaniku mbetet një komunë me potencial të lartë për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Zona ofron kushte të volitshme për zhvillimin e industrisë, blegtorisë, pemëtarisë, zejtarisë dhe turizmit në të gjitha stinët. Bukuritë natyrore, peizazhet malore, si dhe

²³ Të dhëna nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

²⁴ Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për periudhën 2026-2028, fq. 5-6.

infrastruktura rrugore dhe hekurudhore në përmirësim, e pozicionojnë Kaçanikun si pikë lidhjeje strategjike në rajon. Prania e magjistrales Prishtinë-Shkup dhe hekurudhës Fushë Kosovë-Selanik, ndërtuar që në vitin 1879 dhe tashmë në rikonstruktim, rrit vlerën logjistike të komunës.

Gjithashtu, në territorin e Kaçanikut gjenden pasuri minerale si gurë gëlqeror, argjilë dhe lëndë të tjera natyrore që ende nuk janë hulumtuar në mënyrë të thelluar. Ky potencial i pashfrytëzuar, së bashku me pozitën gjeografike, trashëgiminë kulturore dhe fuqinë punëtore, mund ta kthejë Kaçanikun në një pol të ri zhvillimi ekonomik nëse mbështetet me investime serioze dhe strategji afatgjata të orientuara drejt rigjenerimit ekonomik.²⁵

Bizneset: Sipas të dhënave të Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve deri në janar 2026, në Kaçanik ushtrojnë veprimtari 1,696 ndërmarrje. Prej tyre, 1,015 janë biznese individuale, 681 janë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.), ndërsa pjesa tjetër përfshin shoqëri aksionare, ortakëri, biznese të huaja etj. Pronaret femra përfaqësojnë rreth 20.7% të ndërmarrjeve, kryesisht në forma individuale, ndërsa 79.3% u takojnë pronarëve meshkuj. Vitet e fundit është vërejtur një rritje e SH.P.K.-ve, që sinjalizon një tendencë drejt formalizimit të strukturës biznesore.

Aktivitetet që shërbejnë më së shumti nga bizneset përfshijnë: ndërtimi i objekteve banesore dhe jo-banesore, tregtia me pakicë në dyqane të specializuara ku mbizotërojnë ushqimet, pijet dhe duhani, punimet e suvatimit, aktivitetet shërbyese të pijeve, përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave, transporti rrugor i mallrave, aktivitetet e tjera të specializuara të ndërtimit, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, instalimet e tjera ndërtimore, si dhe tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve sanitare..

Ndërmarrjet janë të përqendruara kryesisht në qytetin e Kaçanikut, ku ndodhen 49% e tyre. Fshati Doganaj zë vendin e dytë me 6%, i ndjekur nga Kaçaniku i Vjetër, Dubrava dhe vendbanime të tjera më të vogla. Pothuajse në të gjitha zonat është shënuar rritje e numrit të bizneseve, përveç disa fshatrave ku zhvillimi ka stagnuar.

Informata më të hollësishme sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike për vitin 2023 janë paraqitur në tabelën në vijim.

²⁵ Profili ekonomik i komunës së Kaçanikut, 2023, fq.3-4.

Tab. 9 Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara dhe shuara sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike, 2022-2023 në komunën e Kaçanikut

Nr.	SEKTORËT DHE AKTIVITETET EKONOMIKE	REGJISTRUARA	SHUARA
1	Bujqësi, pylltari dhe peshkatori	1	-
2	Xehetari dhe gurëthyes	-	-
3	Prodhim	2	-
4	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	-	-
5	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	-	-
6	Ndërtimtari	1	-
7	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	4	5
8	Transport dhe ruajtje	1	1
9	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	1	2
10	Informacion dhe komunikim	-	-
11	Aktivitete financiare dhe sigurimit	-	-
12	Aktivitete të patundshmërisë	-	-
13	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2	3
14	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	1	-
15	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	-	-
16	Arsim	-	-
17	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	1	-
18	Art, zbavitje dhe rekreacion	-	-
19	Aktivitete të shërbimeve tjera	2	-
20	Nuk ka të dhëna në ARBK	1	1
Gjithsej		17	12


Burimi: ASK: *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2024*, fq. 228-229.

Shfrytëzimi i tokës: Sipas të dhënave nga regjistri i vitit 1958, sipërfaqja totale e tokës bujqësore ishte 7,643 hektarë, e ndarë në tokë lavërtare (3,087 ha ose 41.36%), livadhe (2,008 ha ose 26.91%) dhe kullosa (2,368 ha ose 31.73%). Aktualisht, vetëm 773 hektarë tokë lavërtare janë të kultivuara, që përfaqëson rreth 25% të sipërfaqes së dikurshme. Brenda kësaj, gruri zë 52.63%, misri 38.78%, patatja 4.15% dhe perimet 4.43%. Pjesa tjetër e tokave lavërtare është uzurpuar nga zhvillime të ndryshme ose është shndërruar në livadhe dhe kullosa, duke reflektuar një shfrytëzim të kufizuar të potencialit bujqësor.

Livadhet dhe kullosat aktualisht përfshijnë një sipërfaqe prej 4,375.78 hektarësh, ku foragjeret janë të përfaqësuara kryesisht nga jonxha me vetëm 60 hektarë. Sipërfaqet e mbjella me perime janë shumë të kufizuara, rreth 32 hektarë, dhe përdoren kryesisht për konsum familjar, me një pjesë të vogël që del në treg. Ndërkohë, pemëtaria përfshin rreth 51 hektarë plantacione të reja, ndërsa ekzistojnë edhe shumë sipërfaqe të tjera me pemë, por ato janë të shpërndara dhe nuk janë të organizuara në forma të strukturuar.²⁶


²⁶ Plani i veprimtimit në mjedis, 2025, fq. 13.

Graf. 14 Struktura e përgjithshme e tokës në komunën e Kaçanikut



Burimi: Përpunuar nga të dhënat e Drejtorisë për Bujqësi.

Graf. 15 Sipërfaqja e tokës bujqësore në komunën e Kaçanikut



Burimi: Plani i veprimt në mjedis, 2025, fq. 13.

Bujqësia dhe blegtoia: Bujqësia vazhdon të luajë një rol thelbësor në aktivitetin ekonomik të komunës së Kaçanikut. Përdorimi i zgjuar dhe efikas i tokave bujqësore mund të ndikojë pozitivisht në krijimin e vendeve të punës dhe të ofrojë një burim të qëndrueshëm të të ardhurave për banorët e zonave rurale. Investimi në përmirësimin e infrastrukturës, mbështetja e drejtpërdrejtë për fermerët dhe avancimi teknologjik në këtë sektor paraqesin mundësi të rëndësishme për zgjerimin dhe modernizimin e bujqësisë, duke kontribuar në zhvillimin afatgjatë ekonomik të komunës.

Sipas të dhënave nga komuna e Kaçanikut, në këtë komunë kultivohen rreth 1,087 ha me kultura bujqësore. Prej tyre dominon gruri me 480 ha, pastaj misri me 440 ha. Elbi dhe thekra përfaqësohen me sipërfaqe më të kufizuara. Pastaj patate 40 ha, arra 30 ha, mollë 20 ha, lajthi 7 ha, mjedër 5 ha etj.



Në aspektin e mekanizimit bujqësor, sipas ASK (2014) komuna dispononte gjithsej 1,023 traktorë. Prej tyre, vetëm 65 (6.4%) ishin më të reja se 10 vjet, ndërsa pjesa dërrmuese, 958 traktora (93.6%), kishin kaluar dhjetëvjeçarin e përdorimit.

Spektori blegtoral në Kaçanik përfshinte 6,048 gjedhë, 4,586 dele, 1,123 dhi dhe 2,062 koshere bletësh, duke pasqyruar një prani të rëndësishme të bujqësisë së integruar me blegtorinë në këtë komunë.

Shpeztaria: Sipas statistikave të ASK-së të vitit 2014, në komunën e Kaçanikut ishin të regjistruara gjithsej 25,279 shpezë. Prej tyre, shumica përbëhej nga pula për vezë me 15,075 individë, duke zënë 59.6% të totalit. Zogjtë e tjerë, përfshirë pulat dhe gjelat, përfaqësonin 8,519 ose 33.7%. Numri i bibave ishte 790 (3.1%), ndërsa kategoria e shpezëve të tjera përfshinte 553, që përbënin 2.2% të fondit të përgjithshëm të shpezëve në komunë.

Pylltaria: Në komunën e Kaçanikut, sektori i pylltarisë përfaqëson një komponent të rëndësishëm ekonomik dhe ekologjik, sidomos për zonat rurale ku aktivitetet pyjore janë të lidhura ngushtë me jetesën e komunitetit lokal. Me një sipërfaqe pyjore prej 12,449 ha, që përbën 59.3% të territorit të komunës, Kaçaniku gëzon një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori.

Pyjet kanë një rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e biodiversitetit, rregullimin e klimës lokale dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, duke kontribuar në mirëqenien ekologjike dhe natyrore të zonës. Si pasojë, mbështetja dhe zhvillimi i sektorit të pylltarisë duhet të jetë pjesë integrale e strategjive afatgjata për zhvillimin ekonomik lokal, përmes planifikimit të qëndrueshëm dhe përfshirjes aktive të komunitetit në ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të resurseve natyrore.

Megjithatë, situata aktuale paraqet një sfidë të konsiderueshme. E gjithë sipërfaqja pyjore në Kaçanik është e klasifikuar si zonë e mbrojtur, pa destinim komercial, çka teorikisht përjashton shfrytëzimin ekonomik të saj. Në praktikë, një pjesë e madhe e këtyre zonave është dëmtuar nga prerjet ilegale, të nxitura nga kërkesat e industrisë së drurit në rajonin e Ferizajt, si dhe nga nevoja e banorëve lokalë për ngrohje. Këto aktivitete jo të autorizuara po rrezikojnë seriozisht kapacitetin ekologjik dhe funksional të pyjeve dhe po kontribuojnë në humbjen graduale të vlerave natyrore të komunës.

Për të përballuar këto sfida, është thelbësore të ndërmerren masa të qarta strategjike që përfshijnë investime në rikuperimin dhe mbrojtjen e zonave të dëmtuara, zbatim rigoroz të legjislacionit mjedisor, ngritje të vetëdijes komunitare dhe zhvillim të mekanizmave efikas të monitorimit dhe menaxhimit. Kjo qasje do të mundësojë jo vetëm mbrojtjen e natyrës, por edhe krijimin e mundësive për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social në Kaçanik, duke siguruar mirëqenie dhe një të ardhme më të gjelbër për brezat që vijnë.

Industria: Pas krijimit të komunës së Hanit të Elezit, Kaçaniku ka përjetuar një rënie të dukshme në intensitetin e zhvillimit industrial, krahasuar me të kaluarën e tij si një zonë me prani të konsiderueshme të industrisë. Sot, ky sektor karakterizohet nga një strukturë e kufizuar dhe me zhvillim të ulët.

Industria e materialeve ndërtimore mbetet segmenti më i spikatur, me përfaqësues si “Silcapor” që prodhon blloka siporeksi, disa ndërmarrje për pllakë betoni, materiale lidhëse, suvatuese dhe

fasaduese, si dhe pesë prodhues të zhavorrit dhe gurëthyesit. Këto biznese përbëjnë pjesën më të madhe të industrisë aktive në Kaçanik. Në të njëjtën linjë, vlen të përmendet edhe një përpunues me bazë druri dhe një operues që përdor gazra djegëse, të cilët paraqesin ndërmarrje të vetme më të strukturuar dhe më serioze në fushën ekonomike.

Zhvillimet e fundit kanë sjellë disa risi, siç është prodhuesi i produkteve plastike “Kivo LLC” dhe dy operatorë të rinj në sektorin e mobilimit, të cilët janë ende në faza të hershme të zhvillimit. Megjithatë, pjesa tjetër e aktiviteteve industriale në komunë mbetet kryesisht në nivel familjar, me kapacitete të kufizuara dhe ndikim të vogël në ekonominë lokale.

Në afërsi të komunës, konkretisht në fshatin Gërlicë të Ferizajt, operon një industri për prodhimin e vajrave motorikë e cila mund të ketë ndikim negativ potencial në mjedis, veçanërisht në ndotjen e tokës dhe burimeve ujore, një çështje që kërkon vëmendje të shtuar për menaxhim të rreziqeve mjedisore dhe mbrojtje të resurseve natyrore të Kaçanikut.²⁷

Resurset minerare: Kaçaniku është i pasur me burime natyrore, veçanërisht me minerale të ndryshme që përfaqësojnë një potencial të madh ekonomik për rajonin. Ndër mineralet më të përhapura janë guri gëlqeror dhe argjila, por zona përmban edhe lloje të tjera mineralesh që deri më tani nuk janë hulumtuar në mënyrë të detajuar.

Sipas të dhënave ekzistuese, në kepin e Kaçanikut janë konstatuar rezerva të gurit gëlqeror që arrijnë në rreth 127 milion ton, ndërsa në zonën e Ivajës janë evidentuar edhe 25 milion ton të tjera. Përveç këtyre, ekzistojnë edhe sasi të konsiderueshme të gurit gëlqeror dhe mineraleve të tjera që ende nuk janë eksploruar apo dokumentuar plotësisht. Ky potencial i pashfrytëzuar paraqet një mundësi të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës, veçanërisht në sektorin e industrisë minerare dhe ndërtimit, duke hapur rrugë për investime të reja dhe krijimin e vendeve të punës.²⁸

Turizmi: Turizmi në Kaçanik është një fushë me potencial të jashtëzakonshëm, e mbështetur nga një natyrë e pasur, trashëgimi kulturore e thellë dhe mikpritje tradicionale që e bëjnë këtë komunë një destinacion tërheqës për vizitorë të brendshëm dhe të jashtëm. Peizazhet malore, sidomos ato të Bjeshkëve të Sharrit, monumentet historike dhe biodiversiteti i rajonit ofrojnë një bazë ideale për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Megjithatë, përkundër këtij potenciali të dukshëm, sektori i turizmit në Kaçanik ende ndodhet në hapat e tij të parë, me infrastrukturë turistike të kufizuar dhe investime të fragmentuara që mbështeten kryesisht nga iniciativa private në fushën hotelierike dhe tregtare.

Komuna e Kaçanikut ka treguar përkushtim për të krijuar kushte më të mira për vizitorët dhe për të identifikuar zonat me vlerë turistike, pavarësisht buxhetit të kufizuar. Zona turistike Shtrazë në Bjeshkët e Sharrit dhe vendndodhja rekreative Te Lushi në Doganaj përfaqësojnë përpjekje konkrete për ta zgjeruar ofertën turistike, por mungesa e koordinimit dhe mbështetjes institucionale në nivel qendror mbetet një sfidë kryesore. Në këtë kontekst, zhvillimi i turizmit kërkon një qasje të integruar dhe strategjike, me fokus në investime infrastrukturore, promovim të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe përfshirje të komunitetit lokal në menaxhimin e

²⁷ Plani i veprimtimit në mjedis, 2025, fq. 14.

²⁸ Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027, fq.10.

aktiviteteve turistike.²⁹Fshati Strazhë shtrihet në pjesën jug-perëndimore të komunës së Kaçanikut

Fshati Strazhë është një prej perlave turistike të Kaçanikut, i vendosur në pjesën jug-perëndimore të komunës³⁰ në një lartësi mbidetare prej 1,000-1,080 metrash. Ai është i rrethuar me më shumë se 150 ha pisha dhe është shpallur monument natyre për shkak të peizazhit të tij të mbrojtur. Zona ofron qetësi, bukuri të paprekur dhe mundësi të shumta për ecje, rekreacion dhe fotografi në natyrë. Po ashtu, liqeni i fshatit Kotlinë, i formuar nga ujërat sipërfaqësore, ndodhet mes fshatrave Kotlinë dhe Ivajë dhe është i rrethuar me florë të larmishme, duke ofruar një ambient ideal për zhvillimin e turizmit rekreativ dhe eksplorim natyror.

Parku Kombëtar “Sharri” shtrihet në juglindje të Kosovës dhe përfshin territore të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Ai përbëhet nga majat e larta dhe të thepisura, liqene akullnajore dhe peizazhe alpine që e bëjnë atë një nga zonat më të bukura të rajonit për ecje, kamping dhe rekreacion. Ky park është një habitat i rëndësishëm për 86 lloje bimësh vaskulare me rëndësi ndërkombëtare, si dhe për kafshë të egra si ariu i murrmë, rrëqebulli, dhia e egër, ujku dhe kaprolli, duke pasuruar më tej vlerat natyrore të rajonit.

Ndër pikat e rëndësishme që duhet përmendur janë edhe Ujëvarat e Korbliqit, të vendosura rreth 13 kilometra larg qendrës së Kaçanikut, si pjesë e vargmaleve të Karadakut të Shkupit. Ato ofrojnë një përvojë të jashtëzakonshme për ecje dhe eksplorim, me bukuri natyrore që tërheqin vizitorë aventurierë. Po ashtu, Maja e Lubotenit, me lartësi mbidetare prej 2,498 metrash, ndodhet në pjesën perëndimore të komunës dhe ofron pamje spektakolare drejt masivit të Sharrit, fushës së Pollogut dhe rrafshit të Kosovës. Ajo është ideale për turizmin malor, duke kombinuar sfidat e lartësive me bukurinë natyrore dhe pasurinë e burimeve ujore, florës dhe faunës.

Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe përfitime afatgjata për ekonominë e Kaçanikut, është e nevojshme një qasje më e koordinuar me përkrahje të nivelit qendror dhe investime në ndërmarrjet lokale të turizmit. Vetëm përmes planifikimit strategjik dhe angazhimit të komunitetit lokal, kjo komunë mund të shndërrohet në një destinacion turistik të standardeve evropiane, duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe promovimin e pasurive natyrore e kulturore të saj.³¹

²⁹ Plani i veprimit në mjedis, 2025, fq. 14.

³⁰ Vendndodhja, korrigjuar nga komuna.

³¹ Profili ekonomik i komunës së Kaçanikut, 2023, fq.21-24.

KRAHASIMI ME VENDET/KOMUNAT TË TJERA – Në krahasim me komunat e tjera të vogla dhe mesatare në Kosovë, komuna e Kaçanikut gëzon disa avantazhe të veçanta që e dallojnë në mënyrë të qartë. Pozita e saj gjeografike në korridoret kryesore të transportit (R6 dhe N2), lidhja me Maqedoninë e Veriut dhe pika kufitare e Gllloboçicës e bëjnë atë një nyje të rëndësishme për tregtinë ndërkufitare. Ky avantazh nuk është i pranishëm në të njëjtën masë në komuna si Dragashi apo Malisheva, të cilat kanë potencial natyror, por nuk gëzojnë të njëjtin akses në rrjete ndërkombëtare transporti. Gjithashtu, pasuritë natyrore dhe klima e përzier mesdhetare-malore e vendosin Kaçanikun në një pozitë të ngjashme me Shtërpçën dhe Deçanin, ku turizmi malor dhe agroturizmi janë sektorë me potencial zhvillimi.

Nga ana tjetër, dobësitë e Kaçanikut janë të krahasueshme me ato të shumë komunave të tjera në Kosovë. Rënia demografike dhe migrimi i të rinjve janë fenomene të përhapura edhe në Ferizaj, Viti apo Suharekë, duke ndikuar në fuqinë punëtore dhe konsumin lokal. Struktura ekonomike e mbështetur kryesisht në mikro-biznese dhe bujqësi tradicionale është një sfidë e përbashkët me shumicën e komunave rurale, ku mungesa e diversifikimit ekonomik dhe mungesa e inkubatorëve për inovacion pengon rritjen e qëndrueshme. Po ashtu, kufizimet buxhetore që detyrojnë fokusin në mirëmbajtje infrastrukturore në vend të projekteve zhvillimore afatgjata janë një realitet i përbashkët për shumicën e komunave të vogla.

Në aspektin e mundësive, Kaçaniku ndan potenciale të ngjashme me komuna si Deçani dhe Juniku, të cilat kanë nisur të zhvillojnë turizmin e qëndrueshëm dhe agroturizmin duke shfrytëzuar fondet IPA dhe partneritetet ndërkombëtare. Po ashtu, mundësitë për energji të ripërtëritshme dhe përfshirja në projekte ndërkombëtare për menaxhimin e mbeturinave janë fusha ku Kaçaniku mund të mësojë nga praktikatat e Ferizajt dhe Prizrenit, që tashmë kanë nisur iniciativat e ngjashme. Bashkëpunimi rajonal me Shkupin dhe Ferizajn për trashëgimi kulturore dhe turizëm trans-ballkanik është një mundësi unike që nuk është e pranishme në të njëjtën formë për komuna të tjera të brendshme.

Në lidhje me kërcënimet, Kaçaniku përballë me sfida që janë të përbashkëta me shumë komuna të Kosovës, si ndryshimet klimatike, migrimi i vazhdueshëm dhe mungesa e stafit të kualifikuar në arsim dhe shëndetësi. Megjithatë, disa rreziqe janë më të theksuara për Kaçanikun, si prerjet ilegale të pyjeve dhe ndotja nga industria e afërt në Ferizaj, që ndikojnë drejtpërdrejt në biodiversitetin lokal. Këto sfida e bëjnë Kaçanikun të ngjashëm me komunat malore si Dragashi dhe Shtërpça, por me një dimension shtesë të presionit industrial nga rajonet fqinje.

Në nivel ndërkombëtar, praktikatat e suksesshme të komunave të vogla në Kroaci, Slloveni dhe Maqedoninë e Veriut tregojnë se zhvillimi i turizmit rural, përpunimi i produkteve bujqësore dhe përdorimi i fondeve të BE-së për digjitalizim dhe energji të ripërtëritshme janë rrugë të qëndrueshme për rritje ekonomike. Kaçaniku mund të përshtasë këto modele, duke i lidhur me asetet e veta natyrore dhe njerëzore, por gjithmonë duke marrë parasysh sfidat unike të migrimit dhe presionit mbi burimet natyrore.

5. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një nga veglat më të rëndësishme që lehtëson procesin e planifikimit strategjik në nivel komunal. Ajo ofron një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi faktorët që ndikojnë në zhvillimin e komunës, duke ndihmuar në identifikimin dhe diskutimin e elementeve kyçe për hartimin e një strategjie efektive dhe të qëndrueshme.

Kjo analizë mbështetet në vlerësimin e dy kategorive kryesore: faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Faktorët e brendshëm përfshijnë përparësitë dhe dobësitë që lidhen me kapacitetet, resurset dhe performancën e komunës. Ndërkohë, faktorët e jashtëm përfshijnë mundësitë dhe rreziqet që burojnë nga mjedisi i jashtëm, si zhvillimet ekonomike, sociale, teknologjike apo politike që mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në objektivat e saj.



Identifikimi i këtyre faktorëve realizohet përmes një vlerësimi të detajuar nga grupi punues, duke përfshirë analiza të sektorëve të ndryshëm të funksionimit komunal. Ky proces mundëson një kuptim të thelluar të situatës aktuale dhe krijon bazën për vendimmarrje të informuar, duke ndihmuar komunën të përcaktojë drejtimet strategjike të zhvillimit.


Analiza SWOT është një vegël fleksibël që mund të aplikohet në kontekste të ndryshme. Ajo mund të përdoret për të vlerësuar opsionet e disponueshme për adresimin e një sfide specifike, për të peshuar mundësitë kundrejt rreziqeve, si dhe për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të bazuara në të dhëna dhe analiza të mirëfillta. Për më tepër, kjo qasje ndihmon komunat të identifikojnë faktorët që mund të lehtësojnë ose pengojnë arritjen e objektivave të tyre.

Rezultatet e analizës SWOT luajnë një rol kyç në planifikimin strategjik. Identifikimi i çështjeve kyçe gjatë këtij procesi kontribuon në formulimin e vizionit, qëllimeve strategjike dhe objektivave të komunës, si dhe në hartimin e programeve dhe projekteve që synojnë maksimizimin e përparësive, reduktimin e dobësive, shfrytëzimin e mundësive dhe menaxhimin e kërcënimeve.

Në rastin e komunës së Kaçanikut, vlerësimi i situatës aktuale është realizuar përmes analizës SWOT. Matrica përkatëse përmbledh përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e identifikuar gjatë këtij procesi, bazuar në të dhënat e mbledhura dhe analizat sektoriale. Kjo analizë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një strategjie të qartë dhe të orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm të komunës.




Përparësitë



- Pozitë gjeografike strategjike në korridoret R6 (Prishtinë–Hani i Elezit) dhe N2, duke lidhur Kosovën me Maqedoninë e Veriut
- Klima e përzier mesdhetare-malore që mbështet bujqësinë, blegtorinë dhe turizmin natyror
- Popullsia e re (41% nën 24 vjeç) dhe raport gjinor i balancuar, me energji inovative dhe potencial për punësim
- Pasuri natyrore të bollshme, tokë, pyje, lumenjtë Lepenc/Nerodime, burime ujore të pastër
- Potencial për zhvillim të energjisë së ripërtëritshme nga burimet ujore dhe diellore
- Kapacitete bujqësore dhe blegtorale të zhvilluara për agroturizëm dhe produkte organike
- Lidhje të fuqishme rrugore dhe hekurudhore, plus pika kufitare Glloboçica për tregti ndërkufitare
- Planifikim urban që synon ruajtjen e tokave bujqësore pranë zgjerimit të qytetit dhe mbrojtjen e hapësirave të gjelbra
- Rrjet rrugor lokal me 332 km (82% të asfaltuara) dhe trotuare në vendbanimet kryesore
- Infrastrukturë moderne ndriçimi publik LED që siguron siguri dhe efikasitet energjetike
- Mbulim i gjerë me ujësjellës dhe kanalizim të organizuar
- Sisteme menaxhimi mbeturinash
- Mbuleshmëri e gjerë me internet kabllor dhe rrjet celular (Vala, Ipko) edhe në zonat rurale të mëdha
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare 24/7 dhe rrjet i shpërndarë i ambulant
- Investime të vazhdueshme në infrastrukturën shkollore dhe rritje vetëdijësi për edukimin e hershëm
- Hapësira kulturore e historike: 67 objekte të mbrojtura, muze, festivale artistike dhe itinerare arkeologjike
- Transparencë institucionale, publikim online i vendimeve dhe buxheteve, përfshirje e publikut në konsultime
- Përdorim i hapësirave shkollore dhe publike për aktivitete kulturore, sportive dhe komunitare
- Legjislacion mjedisor i avancuar për monitorimin e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit
- Ndërtim i programeve të reja banimi me standarde energjetike dhe shtëpi sociale për grupe të pambrojtura




Dobësitë



- Rënie demografike prej 17% (2011–2024) dhe migrim i lartë, sidomos i rinjsh drejt qyteteve të mëdha e jashtë shtetit
- Buxhet komunal detyron prioritet në mirëmbajtje infrastrukture bazë, jo në projekte zhvillimi afatgjatë
- Pjesëmarrje e ulët në arsim parashkollor (vetëm 1 çerdhe, 96 fëmijë) dhe rënie vjetore e nxënësve (–3%)
- Mungesë stafi dhe pajisjesh në qendrat rurale të mjekësisë familjare; pacientët ruralë udhëtojnë drejt qendrës
- Infrastruktura jo-motorike e pamjaftueshme: vetëm 19.8% rrugë me trotuare, asnjë shteg dedikuar biçikletave
- Përdorim i kufizuar i tokës arabile (25% e sipërfaqes aktive) dhe makineri bujqësore e vjetër (93.6% >10 vjet)
- Struktura ekonomike e dobët: dominim i mikro-bizneseve (0.66 punëtorë mesatarisht), bujqësia zë vetëm 4% të ndërmarrjeve
- Kapacitete të kufizuara administrative: 125 punonjës në 9 drejtoritë komunale, vështirësi menaxhimi projektesh të mëdha
- Performancë e ulët në indikatorët e menaxhimit komunal dhe ofrimit të shërbimeve, sipas vlerësimeve të MAPL dhe grantit të performancës
- Nivel i ulët i mbledhjes së taksës së pronës dhe zbatim i pjesshëm i rekomandimeve të auditimit
- Mungesë OJQ–sh në trashëgimi kulturore dhe mbështetje të pamjaftueshme për iniciativat kreative
- Paketë e dobët subvencionesh për fermerët dhe mungesë njohurish teknologjike për modernizim bujqësor
- Infrastruktura tregtare dhe industriale pak e diversifikuar, varësi nga një numër i vogël operatorësh
- Pjesëmarrje e ulët e qytetarëve në konsultime publike dhe mungesë raportimi për proceset e konsultimit
- Mungesë e sistemit të vlerësimit të shërbimeve komunale nga qytetarët, që pengon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë




Mundësitë



- Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm: Maja e Lubotenit (në bashkëpunim me MMPHI, hartimi i një plani rregullues për zhvillimin e kësaj zone – lejimi i ndërtimeve); zgjerimi i zonës turistike Strazhë, duke përfshirë edhe Ivajën dhe Kotlinën; ecje (*hiking*) në Bjeshkët e Sharrit; turizëm kulturor; agroturizëm; ujëvarat e Kërbliqit.
- Eksplorim dhe përpunim i rezervave minerale për gurëthyes, materiale ndërtimi
- Fondet e BE/RKS (MSA, IPA, KAB) për digjitalizim, infrastrukturë rurale, energji të rinovueshme, turizëm dhe arsim
- Inicimin e inkubatorëve socialë dhe inovacion për rininë (41% e popullsisë) në fushat digjitale e artizanale
- Rritje e SME-ve formale: 23% SH.P.K, mundësi grant–kredi për formalizim, dixhitalizim dhe rritje kapacitetesh
- Zbatimi i energjive të rinovueshme: projekte solare në institucione, mini-HEC shtesë, stacione karikimi për EV
- Bashkëpunim rajonal me Ferizaj–Shkup në trashëgimi kulturore, rrjet turistik trans-ballkanik dhe projekte mjedisore
- Përmirësim i zinxhirëve lokalë të vlerës në bujqësi dhe përpunim druri, gurë, mish dhe mjaltë për tregje të brendshme e eksport
- Investime private në infrastrukturë turistike (akomodim, guida lokale, qendra informacioni)
- Zhvillim i e-qeverisjes dhe shërbimeve online për reduktimin e kostove administrative
- Rritje e interesit për partneritete publiko-private në ndërtimin e infrastrukturës komunale dhe objekteve publike
- Përfshirje në projekte ndërkomunale për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e burimeve ujore
- Zgjerim i përdorimit të platformave digjitale për pjesëmarrje qytetare dhe konsultime publike
- Mundësi për përfitim nga grantet për përmirësimin e shërbimeve komunale dhe trajnimin e stafit në e-qeverisje



Rreziqet



- Prerje ilegale të pyjeve (59% e sipërfaqes) dhe ndotja nga industria afër Ferizajt që rrezikojnë biodiversitetin
- Migrim i vazhdueshëm dhe plakje popullsie që ul fuqinë punëtore lokale dhe konsumin brenda komunës
- Konkurrenca për fondet dhe investimet rajonale, ku komunat më të vogla anashkalohen në vendimmarrje qendrore
- Mungesa e një plani multi-modal të transportit publik dhe kapaciteti i dobët për menaxhim të lëvizshmërisë
- Rreziku i sigurisë ushqimore për shkak të varësisë nga importet dhe uljes së tokave të kultivuara (25%)
- Rezistenca lokale ndaj projekteve të mëdha mjedisore (mini-HEC, minerare) dhe konflikte interesi për përdorim toke
- Nevoja për zhvillim të mëtejshëm profesional dhe trajnime të vazhdueshme për stafin në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe administratës është thelbësore, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e shërbimeve në përputhje me standardet e vendeve të zhvilluara
- Rreziku nga rrëshqitjet e dheut në zonat malore, që dëmtojnë rrjetin rrugor dhe kërkojnë ndërhyrje të shpeshta emergjente
- Mosmarrëveshje mes komuniteteve për projektet e kanalizimit dhe menaxhimit të ujërave, që pengojnë zbatimin e projekteve infrastrukturore
- Niveli i ulët i koordinimit ndërinstitutional për menaxhimin e burimeve natyrore dhe mbrojtjen e lumenjve që kalojnë në territorin e komunës
- Rreziku i humbjes së trashëgimisë kulturore për shkak të mungesës së mirëmbajtjes dhe mbështetjes institucionale

6. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Për të garantuar zbatimin efektiv të vizionit dhe misionit të saj, si dhe për të ndërtuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, komuna e Kaçanikut ka identifikuar pesë objektiva strategjike prioritare. Këto fusha përfaqësojnë një ekuilibër të menduar mes rritjes ekonomike, përmirësimit të mirëqenies sociale, zhvillimit urban të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit dhe forcimit të qeverisjes vendore. Përmes këtij kuadri strategjik, komuna synon të krijojë një model zhvillimi që reflekton nevojat e qytetarëve dhe potencialin e saj lokal.

Qëllimi strategjik 1: Nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm lokal synon të krijojë kushte të favorshme për investime, punësim dhe inovacion, duke shfrytëzuar resurset lokale dhe pozicionin gjeografik të komunës. Ky qëllim përfshin funksionalizimin e zonave ekonomike dhe industriale; lehtësimin e procedurave për themelimin dhe zhvillimin e bizneseve; zhvillimin e kapaciteteve lokale për inovacion dhe digjitalizim; promovimin e turizmit lokal si komponent ekonomik; si dhe zbatimin e politikave për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Qëllimi strategjik 2: Përmirësimi i infrastrukturës publike dhe zhvillimi urban ka për qëllim modernizimin e rrjetit rrugor, përmirësimin e shërbimeve bazë dhe krijimin e hapësirave funksionale për komunitetin. Ky qëllim përfshin ndërtimin, asfaltimin, riparimin dhe pastrimin e rrugëve; përmirësimin e rrjetit të furnizimit me ujë; ndërtimin e rrjeteve të ndriçimit publik; ndërtimin e kolektorëve kryesor për largimin e ujërave të zeza; si dhe zhvillimin e hapësirave publike dhe gjelbërimit urban.

Qëllimi strategjik 3: Zhvillimi i bujqësisë dhe mbrojtja e mjedisit synon të rrisë qëndrueshmërinë ekologjike dhe ekonomike të komunës përmes mbështetjes së sektorit rural dhe ruajtjes së pasurive natyrore. Objektivat përfshijnë mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimin rural; mbrojtjen e burimeve ujore dhe tokës bujqësore; mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit; menaxhimin e mbeturinave dhe pastërtinë publike; si dhe edukimin mjedisor dhe ndërgjegjësimin publik.

Qëllimi strategjik 4: Fuqizimi i komuniteteve përmes shëndetit, arsimit dhe përfshirjes sociale ka për synim përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët, me fokus në grupet më të ndjeshme. Ky qëllim përfshin përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe qasjes në kujdesin parësor; zgjerimin e përfshirjes sociale dhe mbështetjen për familjet në nevojë; rritjen e cilësisë në arsim dhe digjitalizimin e shkollave; promovimin e kulturës dhe trashëgimisë kulturore; si dhe zhvillimin e sportit dhe aktiviteteve rekreative.

Qëllimi strategjik 5: Fuqizimi i qeverisjes lokale dhe efikasitetit administrativ synon të modernizojë funksionimin institucional dhe të rrisë besimin e qytetarëve në administratën komunale. Objektivat përfshijnë rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve komunale përmes modelit “one-stop shop”; digjitalizimin e proceseve dhe avancimin drejt një “zyre pa letra”; përmirësimin e infrastrukturës fizike të objekteve komunale; zhvillimin e kapaciteteve

profesionale të stafit komunal; si dhe promovimin e transparencës, barazisë dhe përfshirjes qytetare.

Qëllimi strategjik 1: Nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm lokal

Objektivi specifik 1.1 Funksionalizimi i zonave ekonomike dhe industriale.

Projekti 1.1.1 Përfundimi i infrastrukturës fizike në zonat ekonomike: Zbatimi i punimeve përfundimtare në rrjetin rrugor, kanalizimet, ndriçimin publik dhe furnizimin me energji elektrike në zonat ekonomike të identifikuar, me qëllim krijimin e kushteve optimale për operimin e bizneseve dhe tërheqjen e investimeve.

Projekti 1.1.2 Modeli i menaxhimit të qëndrueshëm për zonat industriale: Hartimi dhe zbatimi i një modeli institucional për menaxhimin e zonave industriale, duke përfshirë strukturat për mirëmbajtje, koordinim me investitorët dhe garantimin e standardeve mjedisore e operacionale për zhvillim afatgjatë.

Projekti 1.1.3 Platforma digjitale për promovimin e zonave ekonomike: Zhvillimi i një platforme interaktive që prezanton zonat ekonomike të Kaçanikut, përfshirë të dhëna mbi infrastrukturën, mundësitë për investim, procedurat ligjore dhe incentivat, me synim rritjen e transparencës dhe tërheqjen e investitorëve potencialë.

Projekti 1.1.4 Panairi Ekonomik i Kaçanikut: Organizimi i një panairi vjetor për promovimin e zonave ekonomike dhe bizneseve lokale, duke krijuar hapësirë për rrjetëzim mes investitorëve, institucioneve dhe sipëmarrësve, si dhe për prezantimin e projekteve zhvillimore.

Projekti 1.1.5 Programi për mbështetje të investitorëve të rinj: Krijimi i një mekanizmi mbështetës për investitorët e rinj, përmes ofrimit të asistencës teknike, këshillimit ligjor dhe ndihmës në përgatitjen e planeve të biznesit, si dhe lehtësimit të qasjes në fondet publike dhe private.

Projekti 1.1.6 Skema e garancisë komunale për bizneset e vogla: Krijimi i një mekanizmi komunal që ofron garanci kreditore për bizneset e vogla, duke lehtësuar qasjen e tyre në financim. Skema do të shoqërohet me asistencë teknike dhe këshillim financiar për përgatitjen e planeve të biznesit dhe aplikimet për fonde.

Objektivi specifik 1.2 Lehtësimi i procedurave për themelimin dhe zhvillimin e bizneseve.

Projekti 1.2.1 Subvencionimi i 50 bizneseve të reja dhe ekzistuese: Përcaktimi i një fondi subvencionues për mbështetjen financiare të 50 bizneseve të reja dhe ekzistuese në Kaçanik, përmes granteve konkurruese që synojnë investime në pajisje, teknologji dhe shërbime për rritjen e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë.

Projekti 1.2.2 Promovimi i bizneseve lokale përmes platformave digjitale dhe fushatave mediatike: Zhvillimi i një fushate të integruar promovuese për bizneset lokale, duke përfshirë krijimin e profileve digjitale, prezantimin në rrjete sociale dhe media lokale, me qëllim rritjen e dukshmërisë dhe zgjerimin e tregut.

Projekti 1.2.3 Shkurtimi i kohës për themelimin biznesi në vetëm 2-3 orë përmes sistemit digjital: Krijimi dhe funksionalizimi i një sistemi digjital për regjistrimin e bizneseve, që mundëson përfundimin e procedurave ligjore dhe administrative brenda 2-3 orëve, duke reduktuar burokracinë dhe përmirësuar efikasitetin institucional.

Projekti 1.2.4 Fushata për ndërgjegjësim dhe edukim mbi ndërmarrësinë: Realizimi i aktiviteteve informuese dhe edukative për qytetarët, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara, me fokus në rëndësinë e ndërmarrësisë, mundësitë për financim dhe hapat për themelimin e një biznesi të suksesshëm.

Projekti 1.2.5 Mbështetje për rritjen e numrit të bizneseve lokale përmes mentorimit dhe rrjeteve: Krijimi i një programi mentorimi dhe rrjetëzimi për sipërmarrësit lokalë, duke ofruar qasje në ekspertizë, këshillim strategjik dhe lidhje me partnerë potencialë, me synim rritjen e numrit dhe cilësisë së bizneseve aktive në komunë.

Objektivi specifik 1.3 Zhvillimi i kapaciteteve lokale për inovacion dhe digjitalizim.

Projekti 1.3.1 Krijimi i Qendrës për Inovacion dhe Teknologji në Kaçanik: Themelimi i një qendre multifunksionale për inovacion dhe teknologji, e pajisur me infrastrukturë moderne për punë, laboratorë digjitalë dhe hapësira për bashkëpunim, me qëllim nxitjen e kreativitetit, zhvillimin e ideve të reja dhe mbështetjen e startup-eve lokale.

Projekti 1.3.2 Trajnime për të rinjtë dhe ndërmarrësit në fushën e digjitalizimit dhe inovacionit: Organizimi trajnimeve për të rinjtë dhe sipërmarrësit, me fokus në aftësitë digjitale, përdorimin e teknologjive të reja, zhvillimin e produkteve inovative dhe aplikimin e zgjidhjeve kreative në biznes dhe administratë.

Projekti 1.3.3 Mbështetje për startup-et dhe idetë inovative përmes fondeve komunale: Krijimi i një skeme financimi nga komuna për startup-et dhe projektet inovative, duke ofruar grante fillestare, mentorim dhe qasje në rrjete profesionale, me synim fuqizimin e ekosistemit lokal të inovacionit.

Projekti 1.3.4 Promovimi i kulturës së inovacionit përmes ngjarjeve dhe konkurseve lokale: Organizimi i aktiviteteve publike si gara për ide inovative, ekspozita teknologjike dhe konferenca, për të nxitur pjesëmarrjen e të rinjve dhe komunitetit në zhvillimin e zgjidhjeve kreative dhe digjitale.

Objektivi specifik 1.4 Zhvillimi i turizmit lokal si komponent ekonomik.

Projekti 1.4.1 Hartimi i strategjisë lokale për zhvillimin e turizmit: Draftimi i një dokumenti strategjik për zhvillimin e turizmit në Kaçanik, që identifikon asetet

natyrore, kulturore dhe historike, përcakton prioritetet investuese dhe përfshin masa për promovim, menaxhim të qëndrueshëm dhe përfshirje të komunitetit lokal.

Projekti 1.4.2 Krijimi i pikave turistike informuese dhe sinjalistikës: Vendosja e pikave informuese në hyrjet kryesore të komunës dhe pranë atraksioneve turistike, si dhe instalimi i sinjalistikës orientuese dhe interpretative për të përmirësuar përvojën e vizitorëve dhe rritur qasjen në destinacionet lokale.

Projekti 1.4.3 Promovimi i destinacioneve lokale përmes platformave digjitale: Zhvillimi i një platforme digjitale dhe fushatash online për prezantimin e atraksioneve turistike të Kaçanikut, përfshirë përshkrime, foto, itinerare dhe informacione praktike, me qëllim rritjen e vizibilitetit dhe tërheqjen e vizitorëve.

Projekti 1.4.4 Organizimi i ngjarjeve kulturore dhe festivaleve për tërheqje turistike: Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve kulturore, festivaleve tradicionale dhe ekspozitave artistike që promovojnë trashëgiminë lokale dhe krijojnë arsye për vizita turistike, duke përfshirë komunitetin dhe sektorin privat në organizim.

Projekti 1.4.5 Përmirësimi i infrastrukturës lokale në zonat turistike: Rehabilitimi i rrugëve hyrëse, shtigjeve, sinjalistikës, ndriçimit dhe hapësirave të parkimit në destinacionet kryesore turistike të Kaçanikut, me synim rritjen e qasjes, sigurisë dhe atraktivitetit për vizitorët.

Objektivi specifik 1.5 Zbatimi i politikave për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Projekti 1.5.1 Zbatimi i strategjisë komunale për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm: Fillimi i zbatimit të masave prioritare të parashikuara në strategjinë komunale, përfshirë projektet infrastrukturore, mbështetjen për ndërmarrjet lokale, promovimin e investimeve dhe zhvillimin e sektorëve me potencial të lartë. Do të përfshijë gjithashtu monitorimin e progresit përmes indikatorëve të matshëm.

Projekti 1.5.2 Funksionalizimi i mekanizmave për konsultim publik dhe partneritet me sektorin privat: Aktivizimi i platformave të konsultimit të krijuara gjatë fazës së hartimit, duke organizuar takime të rregullta, publikime të hapura dhe bashkëpunime konkrete me biznese lokale për zbatim të projekteve të përbashkëta.

Projekti 1.5.3 Zhvillimi i kapaciteteve të stafit komunal për zbatim të politikave ekonomike: Trajnime të avancuara për zyrtarët komunalë mbi menaxhimin e projekteve, raportimin e indikatorëve, mobilizimin e fondeve dhe bashkëpunimin ndërinstitutional. Fokus i veçantë do t'i jepet zbatimit praktik të politikave të qëndrueshme dhe integritetit të tyre në buxhetin komunal.

Projekti 1.5.4 Ndërtimi i kioskave për biznese në Bulevard, Sheshin e qytetit dhe pika tjera turistike: Zbatimi i një iniciative për përmirësimin e infrastrukturës

komerciale në hapësirat publike, përmes ndërtimit të kioskave funksionale për biznese të vogla dhe artizanale. Projekti synon të gjallërojë ekonominë lokale, të rrisë atraktivitetin turistik dhe të krijojë mundësi të reja vetëpunësimi. Kioskat do të vendosen në lokacione strategjike si Bulevardi, Sheshi i qytetit dhe pikat turistike, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe ekonomik.

Projekti 1.5.5 Zhvillimi i projekteve turistike për promovimin e resurseve lokale: Zbatimi i projekteve të fokusuara në promovimin e turizmit rural, kulturor dhe natyror në Komunën e Kaçanikut, përmes investimeve në infrastrukturë, sinjalistikë, marketing dhe bashkëpunim me sektorin privat. Projekti synon të rrisë vizitueshmërinë, të gjenerojë të ardhura për komunitetin lokal dhe të pozicionojë Kaçanikun si destinacion të qëndrueshëm turistik. Aktivitetet do të përfshijnë edhe trajnime për operatorët lokalë dhe krijimin e paketave turistike të integruara.

Projekti 1.5.6 Panairi i punës për të rinj dhe gra: Organizimi i një panairi vjetor që lidh të rinjtë dhe gratë punëkërkuese me bizneset dhe institucionet, duke ofruar mundësi punësimi, praktikash dhe trajnimesh.

Qëllimi strategjik 2: Përmirësimi i infrastrukturës publike dhe zhvillimi urban

Objektivi specifik 2.1. Ndërtimi, asfaltimi, riparimi dhe pastrimi i rrugëve.

Projekti 2.1.1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Ismail Raka, segmenti prej Shtëpisë së Kulturës deri te Xhamia e Dëshmorëve: Rehabilitimi i këtij segmenti rrugor synon përmirësimin e qasjes në zonën qendrore të qytetit, duke lehtësuar lëvizjen për banorët dhe vizitorët, si dhe duke rritur sigurinë rrugore dhe estetikën urbane.

Projekti 2.1.2 Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Runjevë-Stagovë-Kaçanik i Vjetër: Ky projekt përmirëson lidhjen ndërmjet zonave rurale dhe qendrës urbane, duke mundësuar qasje më të mirë në shërbime publike dhe tregje, si dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik lokal.

Projekti 2.1.3 Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari" segmenti Silkapor-Rakaj: Zbatimi i këtij projekti synon të eliminojë vështirësitë infrastrukturore në një segment të rëndësishëm për banorët lokalë, duke përmirësuar sigurinë dhe qarkullimin.

Projekti 2.1.4 Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës Bob-Doganaj: Ky projekt kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonat periferike, duke lehtësuar qasjen në institucionet publike dhe duke rritur cilësinë e jetës.

Projekti 2.1.5 Ndërtimi i trotuarit, shtigjet për çiklizëm dhe rehabilitimi i rrugës "Adem Jashari" - Stagovë: Synon të promovojë transportin alternativ dhe të

sigurojë lëvizje të sigurt për këmbësorët dhe çiklistët, duke kontribuar në një mjedis më të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

Projekti 2.1.6 Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane - Kaçanik: Modernizimi i rrugëve urbane do të përmirësojë funksionalitetin e qytetit, do të lehtësojë qarkullimin dhe do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe social.

Projekti 2.1.7 Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale - Kaçanik: Ky projekt synon të zvogëlojë izolimin e fshatrave, të përmirësojë qasjen në shërbime dhe të nxisë integrimin territorial.

Projekti 2.1.8 Ndërtimi i rrugës "Reshat Shehu" me trotuare: Përmirëson sigurinë rrugore dhe qasjen për këmbësorët në një zonë me densitet të lartë banimi, duke kontribuar në zhvillimin urban të qëndrueshëm.

Projekti 2.1.9 Ndërtimi i mureve mbrojtëse në rrugën Hamëz Jashari - Mejdi Dalloshi - Shaban dhe Isen Elezi: Parandalon erozionin dhe dëmtimet infrastrukturore në zona të ndjeshme, duke siguruar stabilitetin e rrugës dhe mbrojtjen e banesave përreth.

Projekti 2.1.10 Zgjerimi i rrugës Gryka e Kaçanikut - Kaçanik i Vjetër: Rrit kapacitetin rrugor dhe përmirëson lidhjen me zonat turistike dhe natyrore, duke nxitur zhvillimin e turizmit dhe mobilitetin lokal.

Projekti 2.1.11 Vendosja e sinjalistikës rrugore dhe sistemit të sigurisë: Instalimi i tabelave informuese, vijave ndarëse, ndriçimit të kryqëzimeve dhe sistemit të kamerave për siguri rrugore në rrugët e reja dhe ekzistuese.

Objektivi specifik 2.2. Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë.

Projekti 2.2.1 Evidentimi i gjendjes së rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit: Ky projekt synon të hartojë një pasqyrë të detajuar të rrjeteve ekzistuese të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke identifikuar zonat me deficite dhe nevoja për ndërhyrje, si bazë për planifikim të qëndrueshëm.

Projekti 2.2.2 Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujit të pijes në Septin: Krijon kapacitete të reja për trajtimin e ujit të pijshëm, duke garantuar furnizim të sigurt dhe cilësor për komunitetin lokal, në përputhje me standardet mjedisore dhe shëndetësore.

Projekti 2.2.3 Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjellësve në lokalitet: Kaçanik dhe Vataj të Epërme - Dubravë: Zgjidh problemet e furnizimit me ujë në zonat me mungesë infrastrukture, duke përmirësuar jetesën dhe shëndetin publik.

Projekti 2.2.4 Fushatë informuese dhe edukative për përdorimin racional dhe të qëndrueshëm të ujit në familje, shkolla dhe biznese: Ndërgjegjëson komunitetin për ruajtjen e burimeve ujore, promovon sjellje të përgjegjshme dhe ul konsumin e panevojshëm.

Objektivi specifik 2.3. Ndërtimi i rrjeteve të ndriçimit publik.

Projekti 2.3.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese: Identifikon zonat me mungesë ndriçimi publik dhe krijon bazën për planifikim të drejtë dhe efikas të investimeve.

Projekti 2.3.2 Përpilimi i listës për ndriçim sipas prioritetit: Harton një listë të lokaliteteve dhe rrugëve që kanë nevojë urgjente për ndriçim, duke u bazuar në siguri, frekuencë lëvizjeje dhe nevoja komunitare.

Projekti 2.3.3 Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e plotë e tij në qytetin e Kaçanikut dhe në fshatrat: Zbatimi i këtij projekti përmirëson sigurinë publike, rrit cilësinë e jetës dhe kontribuon në zhvillimin e mjedisit urban dhe rural.

Projekti 2.3.4 Ndriçimi i hapësirave publike dhe parqeve: Krijon ambiente të sigurta dhe tërheqëse për rekreacion, duke gjallëruar jetën komunitare dhe promovuar aktivitete sociale.

Projekti 2.3.5 Mirëmbajtja dhe modernizimi i ndriçimit ekzistues: Zëvendëson sistemet e vjetra me teknologji efikase energjike, duke ulur kostot operative dhe përmirësuar performancën.

Projekti 2.3.6 Programi i efikasitetit të energjisë në shkollat dhe QMF: Zbatimi i masave për kursimin e energjisë në shkollat dhe qendrat e kujdesit shëndetësor përmes instalimit të ndriçimit LED, përmirësimit të izolimit termik dhe vendosjes së paneleve solare. Projekti synon të ulë kostot operative, të përmirësojë kushtet e mësimi dhe shërbimit shëndetësor, si dhe të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit përmes reduktimit të emetimeve.

Objektivi specifik 2.4. Ndërtimi i kolektorëve kryesor për largimin e ujërave të zeza.

Projekti 2.4.1 Ndërtimi i kolektorit përgjatë lumit Lepenc dhe Nerodime: Parandalon ndotjen e lumenjve dhe përmirëson menaxhimin e ujërave të zeza në zonat urbane dhe rurale.

Projekti 2.4.2 Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike: Zgjidh problemet sanitare dhe përmirëson kushtet e jetesës, duke reduktuar rrezikun nga ndotja dhe përmbytjet.

Objektivi specifik 2.5. Zhvillimi i hapësirave publike dhe gjelbërimit urban.

Projekti 2.5.1 Ndërtimi dhe rehabilitimi i hapësirave publike: Ky projekt synon të krijojë dhe të përmirësojë sheshet, parqet dhe zonat rekreative në qytet dhe fshatra, duke ofruar ambiente funksionale dhe të sigurta për qytetarët, si dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe estetikës urbane.

Projekti 2.5.2 Krijimi i zonave të gjelbra dhe mbjellja e pemëve: Synon të zgjerojë sipërfaqet e gjelbra përmes mbjelljes së pemëve dhe bimësisë dekorative në rrugë, shkollat dhe institucione publike, duke përmirësuar cilësinë e ajrit dhe duke krijuar ambiente më të shëndetshme për komunitetin.

Projekti 2.5.3 Ndërtimi i urave për qasje në hapësira publike: Ky projekt synon të përmirësojë lidhjen ndërmjet lagjeve dhe zonave rekreative përmes ndërtimit të urave funksionale mbi lumin Lepenc, duke lehtësuar qasjen, sigurinë dhe integrimin urban.

Projekti 2.5.4 Instalimi i sistemit të ujitjes për parqe dhe gjelbërim: Mirëmbajtje e qëndrueshme e zonave të gjelbra përmes instalimit të sistemeve automatike të ujitjes, duke rritur efikasitetin operativ dhe cilësinë e bimësisë dekorative.

Qëllimi strategjik 3: Zhvillimi i bujqësisë dhe mbrojtja e mjedisit

Objektivi specifik 3.1 Mbështetja e bujqësisë dhe zhvillimi rural.

Projekti 3.1.1 Subvencionimi i fermerëve për blerjen e pajisjeve bujqësore: Ky projekt synon të rrisë kapacitetin prodhues të fermerëve lokalë përmes mbështetjes financiare, duke përmirësuar efikasitetin dhe konkurrueshmërinë në sektorin bujqësor.

Projekti 3.1.2 Trajnime për teknika të bujqësisë së qëndrueshme dhe agro-ekologjike: Zbatimi i këtij projekti fuqizon njohuritë e fermerëve për praktika miqësore me mjedisin, duke kontribuar në ruajtjen e tokës dhe rritjen e cilësisë së prodhimit.

Projekti 3.1.3 Mbështetje për bujqësinë organike dhe certifikimin e produkteve lokale: Promovon prodhimin e pastër dhe të certifikuar, duke krijuar mundësi të reja për tregje dhe rritur besimin e konsumatorëve në produktet vendore.

Projekti 3.1.4 Përmirësimi i zinxhirit të vlerës në bujqësi përmes përkrahjes së pikave grumbulluese: Mbështetje për krijimin dhe funksionalizimin e pikave grumbulluese të produkteve bujqësore, me synim lehtësimin e qasjes së fermerëve në treg, rritjen e cilësisë dhe forcimin e zinxhirit të vlerës nga prodhimi deri te shitja.

Objektivi specifik 3.2 Mbrojtja e burimeve ujore dhe tokës bujqësore.

Projekti 3.2.1 Fushatë vetëdijësuese për përdorimin racional të ujit në bujqësi: Ndërgjegjëson komunitetin bujqësor për ruajtjen e burimeve ujore, duke promovuar teknika efikase të ujitjes dhe reduktimin e humbjeve.

Projekti 3.2.2 Ndërtimi i rezervuarëve të vegjël për ujitje në fshatra prioritarë: Krijon kapacitete të reja për menaxhimin e ujit në bujqësi, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm për tokat bujqësore dhe rritur rezistencën ndaj thatësirës.

Objektivi specifik 3.3 Mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit.

Projekti 3.3.1 Ndërtimi i shtretërve të lumenjve dhe përrockave: Stabilizon rrjedhat natyrore dhe parandalon erozionin, duke mbrojtur infrastrukturën dhe tokat bujqësore në zonat e rrezikuara.

Projekti 3.3.2 Pastrimi dhe mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve dhe përrockave: Përmirëson qarkullimin natyror të ujit dhe redukton ndotjen, duke kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe sigurinë mjedisore.

Objektivi specifik 3.4. Menaxhimi i mbeturinave dhe pastërtia publike.

Projekti 3.4.1 Evidentimi i lokaliteteve pa mbulim me shërbime mbeturinash: Krijimi i një baze të dhënash të detajuar për menaxhimin e mbeturinave, e cila do të mirëmbajtet nga Zyra për Menaxhimin e Mbeturinave në komunë, me qëllim planifikimin, monitorimin dhe kontrollin efikas të shërbimit.

Projekti 3.4.2 Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave: Zgjerimi i mbulimit me shërbime të grumbullimit të mbeturinave në të gjitha vendbanimet që aktualisht nuk përfshihen në sistemin komunal (si p.sh.. Kotlina, Gjurgjedelli, Kerbliqi), si dhe rritja e përfshirjes së plotë të qytetarëve në vendbanimet ku shërbimi ekziston, por nuk ka mbulim të plotë të banorëve.

Projekti 3.4.3 Rritja e mbulueshmërisë me shërbime për mbeturina në nivel komunal: Ky projekt synon të rrisë mbulimin e territorit komunal me shërbime të rregullta për grumbullimin e mbeturinave deri në 90% deri në fund të vitit 2029, duke kontribuar në pastërtinë publike dhe mbrojtjen e mjedisit.

Projekti 3.4.4 Qendra e riciklimit për plastikën dhe materialet e ndërtimit: Krijimi i një qendre për grumbullimin dhe riciklimin e plastikës dhe mbetjeve të ndërtimit, me synim uljen e ndotjes, zvogëlimin e mbeturinave në deponi dhe krijimin e mundësive të reja punësimi përmes ekonomisë qarkore.

Objektivi specifik 3.5. Edukimi mjedisor dhe ndërgjegjësimi publik.

Projekti 3.5.1 Fushatë edukative për ndarjen dhe reduktimin e mbeturinave në familje, shkolla dhe biznese: Promovon sjellje të përgjegjshme ndaj mbeturinave, duke rritur vetëdijen dhe përmirësuar menaxhimin mjedisor në nivel komunitar.

Projekti 3.5.2 Aktivizimi i grupeve rinore për aksione ekologjike dhe pastrimi: Fuqizon pjesëmarrjen qytetare dhe angazhimin rinor në mbrojtjen e mjedisit, duke gjallëruar jetën komunitare dhe ndërtuar kulturë ekologjike.

Qëllimi strategjik 4: Fuqizimi i komuniteteve përmes shëndetit, arsimit dhe përfshirjes sociale

Objektivi specifik 4.1 Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe qasjes në kujdesin parësor.

Projekti 4.1.1 Sigurimi i stafit dhe pajisjeve adekuate në QKMF: Përmirësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor përmes angazhimit të stafit profesional dhe furnizimit me pajisje moderne në objektet ekzistuese të QKMF-së, duke garantuar standarde të larta të shërbimit.

Projekti 4.1.2 Blerja e veturës për pacientët me hemodializë dhe aparatit biokimik: Rritja e sigurisë dhe efikasitetit në transportin e pacientëve me nevoja të veçanta, si dhe përmirësimi i kapaciteteve diagnostikuese përmes pajisjeve laboratorike të avancuara.

Projekti 4.1.3 Renovimi dhe furnizimi i QMF-ve me pajisje mjekësore: Modernizimi i objekteve ekzistuese të QMF-ve përmes renovimeve infrastrukturore dhe furnizimit me pajisje të nevojshme për ofrimin e shërbimeve cilësore në nivel lokal.

Projekti 4.1.4 Ndërtimi i depos dhe garazhës në QKMF: Krijimi i hapësirave funksionale për ruajtjen e materialeve mjekësore dhe strehimin e automjeteve shëndetësore, duke rritur efikasitetin logjistik dhe sigurinë operacionale të QKMF-së.

Projekti 4.1.5 Mirëmbajtja intensive në QKMF: Zbatimi i masave të rregullta dhe investive për mirëmbajtjen e objektit të QKMF-së, me qëllim të ruajtjes së kushteve optimale për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Objektivi specifik 4.2 Zgjerimi i përfshirjes sociale dhe mbështetja për familjet në nevojë.

Projekti 4.2.1 Regjistrimi dhe targetimi i familjeve në nevojë: Krijimi i një baze të dhënash të përditësuar për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale (QPS) dhe strukturat komunale.

Projekti 4.2.2 Ndhurma materiale dhe financiare për familjet në nevojë: Ofrimi i pakove ushqimore, veshmbathjeve dhe mbështetje financiare për familjet më të rrezikuara.

Projekti 4.2.3 Ndërtimi i objekteve për banim social: Ndërtimi i dy objekteve për strehim të përhershëm për familjet pa kushte banimi, me kapacitet minimal për 24 familje.

Projekti 4.2.4 Zvogëlimi i varësisë nga ndihma sociale: Zbatimi i politikave për punësim, përkrahje në bujqësi dhe zhvillim ekonomik për të rritur vetëqëndrueshmërinë e familjeve.

Projekti 4.2.5 Ndërtimi i Qendrës për Punë Sociale: Krijimi i një objekti funksional për ofrimin e shërbimeve sociale, këshilluese dhe koordinimin e asistencës për familjet në nevojë.

Objektivi specifik 4.3 Rritja e cilësisë në arsim dhe digjitalizimi i shkollave.

Projekti 4.3.1 Ndërtimi i sallës së Edukatës Fizike në SHFMU "Kadri Zeka" – Dubravë: Ndërtimi i një salle moderne për edukatë fizike për nxënësit e shkollës fillore.

Projekti 4.3.2 Vendosja e paneleve diellore në objektet shkollore: Instalimi i sistemeve solare për kursim energjie në shkollat fillore dhe të mesme.

Projekti 4.3.3 Digjitalizimi i SHFMU "Emin Duraku" – Kaçanik: Pajisja me teknologji digjitale për klasat dhe mësimdhënësit e shkollës.

Projekti 4.3.4 Digjitalizimi i SHFMU-ve (shkolla të tjera fillore): Pajisja me laptopë, projektorë dhe rrjet digjital për shkollat fillore të tjera.

Projekti 4.3.5 Digjitalizimi i SHML-ve (shkolla të mesme): Pajisja me teknologji për shkollat e mesme të Kaçanikut.

Projekti 4.3.6 Vendosja e paneleve diellore në IAAP "Feriz Guri" dhe "Vëllezërit Çaka": Instalimi i paneleve solare në dy shkolla të mesme për kursim energjie.

Projekti 4.3.7 Trajnimi i mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë: Trajnime për përdorimin e mjeteve digjitale dhe platformave online.

Projekti 4.3.8 Punësimi i psikologëve dhe pedagogëve në shkolla: Angazhimi i stafit profesional për mbështetje emocionale dhe edukative.

Projekti 4.3.9 Rritja e numrit të asistentëve: Angazhimi i asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta.

Projekti 4.3.10 Vendosja e kamerave të sigurisë: Instalimi i sistemit të kamerave në shkollat publike.

Projekti 4.3.11 Mirëmbajtja e hapësirave shkollore: Renovime të vogla, sanitari, ndriçim, ngrohje.

Projekti 4.3.12 Pajisja me inventar të nevojshëm: Tavalina, karrige, rafte, mjete didaktike.

Projekti 4.3.13 Bursa për studentët e dalluar: Mbështetje financiare për studentët me rezultate të larta.

Projekti 4.3.14 Programi i trajnimeve praktike në vend të punës: Zbatimi i një programi për trajnime praktike në bashkëpunim me bizneset lokale dhe institucionet publike, duke u mundësuar nxënësve dhe të rinjve të fitojnë përvojë reale pune. Projekti synon të rrisë aftësitë profesionale, të lehtësojë tranzicionin nga shkolla në tregun e punës dhe të përmirësojë punësueshmërinë e të rinjve në Kaçanik.

Objektivi specifik 4.4 Promovimi i kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Projekti 4.4.1 Rregullimi i varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-së: Rregullimi i infrastrukturës për varrezat e Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-së

në Kaçanik, me qëllim krijimin e një hapësire të denjë për përkujtim, ceremoni zyrtare dhe respekt institucional ndaj trashëgimisë historike.

Projekti 4.4.2 Përmirësimi i objekteve kulturore ekzistuese: Renovimi dhe funksionalizimi i Shtëpisë së Kulturës, bibliotekës dhe galerisë komunale për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve artistike, edukative dhe rinore në kushte të përshtatshme.

Projekti 4.4.3 Subvencionimi i shoqërive kulturore-artistike dhe grupeve rinore: Mbështetje financiare për shoqëri folklorike, grupe muzikore, teatrore dhe organizata rinore që promovojnë trashëgiminë kulturore dhe aktivizimin e të rinjve në jetën publike.

Projekti 4.4.4 Digitalizimi i arkivës kulturore dhe historike të Kaçanikut: Mbledhja, skanimi dhe publikimi online i dokumenteve, fotografive dhe materialeve historike të Kaçanikut për ruajtje afatgjate dhe qasje publike.

Objektivi specifik 4.5 Zhvillimi i sportit dhe aktiviteteve rekreative.

Projekti 4.5.1 Ndërtimi i fushës multifunksionale sportive në qytet: Ndërtimi i një fushe të hapur për futboll të vogël, basketboll dhe volejball, me ndriçim, rrethim dhe ulëse për shikues, e dedikuar për përdorim nga shkollat, klubet sportive dhe komuniteti.

Projekti 4.5.2 Renovimi i palestrës sportive komunale: Përmirësimi i palestrës ekzistuese për të mundësuar zhvillimin e garave komunale, trajnimeve dhe aktiviteteve rinore, duke përfshirë ndërrimin e dyshemesë, ndriçimit, sistemit të ngrohjes dhe pajisjeve sportive.

Projekti 4.5.3 Subvencionimi i klubeve sportive lokale: Mbështetje financiare për klubet e futbollit, basketbollit, mundjes dhe sporteve tjera për pjesëmarrje në gara, blerje pajisjesh, trajnime dhe organizim të aktiviteteve komunitare.

Projekti 4.5.4 Krijimi i Qendrës Rinore Komunale: Hapja e një qendre multifunksionale për të rinjtë, me hapësira për aktivitete edukative, kreative, digjitale dhe sociale, duke përfshirë sallë për punëtori, bibliotekë, pajisje IT dhe ambiente për diskutime.

Projekti 4.5.5 Vazhdimi i punimeve në stadiumin Besnik Begunca dhe fushës ndihmëse: Finalizimi i infrastrukturës sportive për ndeshje, stërvitje dhe aktivitete komunitare, duke përfshirë ndriçimin, tribuna, rrethimin etj.

Qëllimi strategjik 5: Fuqizimi i qeverisjes lokale dhe efikasitetit administrativ

Objektivi specifik 5.1 Rritja e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve komunale përmes modelit “one-stop shop”.

Projekti 5.1.1 Zhvillimi i modelit “One-Stop Shop” në Qendrën për Shërbim me Qytetarë (QSHQ): Krijimi i një pike të vetme për ofrimin e shërbimeve komunale, ku qytetarët mund të marrin informacione, të dorëzojnë dokumente dhe të përfundojnë procedura pa pasur nevojë të kalojnë nëpër drejtoritë e ndryshme. Synon të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë përvojën e qytetarëve.

Projekti 5.1.2 Optimizimi i protokolleve të shërbimit me qytetarë: Rishikimi dhe standardizimi i procedurave të shërbimit publik për të siguruar trajtim të barabartë, komunikim të qartë dhe zgjidhje më të shpejta për kërkesat e qytetarëve.

Projekti 5.1.3 Vendosja e sistemit të vlerësimit të shërbimeve: Krijimi i mekanizmave për matjen e kënaqësisë së qytetarëve përmes sondazheve dhe formularëve të vlerësimit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Projekti 5.1.4 Harmonizimi i strategjive komunale me strategjitë nacionale: Rishikimi dhe përshtatja e dokumenteve strategjike komunale për t'i harmonizuar me PNZHEL 2030 dhe strategjitë e tjera kombëtare, duke siguruar koherencë, shmangie të mbivendosjeve dhe zbatim më efektiv të politikave zhvillimore.

Objektivi specifik 5.2 Digjitalizimi i proceseve dhe avancimi drejt një “zyre pa letra”.

Projekti 5.2.1 Digjitalizimi i regjistrit civil dhe arkivës: Skanimi dhe sistemimi elektronik i dokumenteve të regjistrit civil dhe arkivës komunale, për të lehtësuar qasjen dhe ruajtjen afatgjate të të dhënave.

Projekti 5.2.2 Platforma për shërbime online për qytetarë dhe biznese: Zhvillimi i një portali digjital për aplikime, kërkesa dhe informacione komunale, me qasje të lehtë dhe të sigurt për qytetarët dhe bizneset.

Projekti 5.2.3 Implementimi i sistemit të menaxhimit elektronik të dokumenteve: Automatizimi i qarkullimit të dokumenteve brenda komunës përmes një sistemi digjital, duke reduktuar përdorimin e letrës dhe përmirësuar koordinimin institucional.

Objektivi specifik 5.3 Përmirësimi i infrastrukturës fizike të objekteve komunale.

Projekti 5.3.1 Rregullimi i sistemit të ngrohjes qendrore – Faza II: Përmirësimi i kushteve termike në objektin komunal përmes modernizimit të sistemit të ngrohjes dhe rritjes së efikasitetit energjetik.

Projekti 5.3.2 Ndërtimi i parkingut nëntokësor: Krijimi i një hapësire të dedikuar për parkim nëntokësor për qytetarët dhe stafin komunal, me qëllim lehtësimin e qasjes dhe reduktimin e ngarkesës në trafik.

Projekti 5.3.3 Ndërtimi i aneksit të administratës komunale: Zgjerimi i hapësirave për shërbime komunale përmes ndërtimit të një aneksi të ri, duke përmirësuar organizimin dhe funksionalitetin institucional.

Projekti 5.3.4 Adaptimi i objekteve për qasje universale: Përshtatja e objekteve komunale për personat me aftësi të kufizuara përmes rampave, sinjalistikës dhe pajisjeve ndihmëse, në përputhje me standardet ligjore.

Objektivi specifik 5.4 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit komunal.

Projekti 5.4.1 Trajnime për etikë profesionale dhe komunikim me publikun: Organizimi i trajnimeve për përmirësimin e ndërveprimit me qytetarët dhe respektimin e standardeve etike në shërbim publik.

Projekti 5.4.2 Trajnime për përdorimin e TIK dhe e-qeverisje: Aftësimi i stafit për përdorimin e platformave digjitale dhe sistemeve elektronike të menaxhimit të dokumenteve dhe komunikimit institucional.

Projekti 5.4.3 Program për zhvillim të vazhdueshëm profesional: Krijimi i një kalendari të rregullt për trajnime ndërsektoriale, me fokus në menaxhim projektesh, raportim dhe bashkëpunim ndërinstitutional.

Objektivi specifik 5.5 Promovimi i transparencës, barazisë dhe përfshirjes qytetare.

Projekti 5.5.1 Platforma e Transparencës Komunale: Zhvillimi i një platforme digjitale për publikimin e vendimeve, buxheteve dhe raportimeve komunale, me qasje të hapur për qytetarët.

Projekti 5.5.2 Forume të rregullta me qytetarët: Organizimi i takimeve publike për konsultim mbi politikat dhe projektet komunale, me qëllim përfshirjen aktive të komunitetit në vendimmarrje.

Projekti 5.5.3 Programi për barazi gjinore: Mbështetje për Zyrën e Barazisë Gjinore përmes aktiviteteve promovuese, trajnimeve dhe integritit të parimeve të barazisë në politikat komunale.

Projekti 5.5.4 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për rritjen e shkallës së inkasimit të të hyrave vetanake: Fushata informuese për qytetarët mbi rëndësinë e pagesës së taksave dhe tarifave komunale, me synim rritjen e inkasimit dhe forcimin e vetëqëndrueshmërisë financiare të komunës.

7. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2030 e Komunës së Kaçanikut përfshin një plan veprimi trevjeçar (shih Shtojcën 1) që mbulon vitet 2026–2028, duke specifikuar aktivitetet, afatet kohore, kostot, burimet e financimit dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin. Plan i veprimit do të rishikohet në baza vjetore (*sipas nevojës*), në kuadër të planifikimit të monitorimit të përcaktuar në strategji. Monitorimi i zbatimit do të realizohet përmes indikatorëve matës të vendosur në nivel të objektivave specifike, duke mundësuar një vlerësim të vazhdueshëm dhe të matshëm të progresit.

Për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie, komuna e Kaçanikut do të zbatojë një mekanizëm sistematik të raportimit. Komuna do të formojë një grup punues për monitorimin e implementimit të planit të veprimit, i cili do të ketë mandat të qartë dhe afate kohore për raportim. Raportet periodike do të dorëzohen në Kuvendin Komunal brenda tremujorit të parë të vitit pasues dhe do të analizojnë përmbushjen e objektivave strategjike, ndikimin e projekteve, qëndrueshmërinë e rezultateve, si dhe problemet e hasura gjatë zbatimit, duke ofruar masa korrigjuese dhe bazë për adaptim të politikave në përputhje me nevojat e komunitetit.

Vlerësimi afatmesëm, i planifikuar për vitin 2027, do të shërbejë për identifikimin e progresit dhe sfidave, si dhe për ri-vlerësimin e treguesve dhe aktiviteteve aty ku është e nevojshme, pa ndryshuar objektivat e përgjithshme dhe specifike të strategjisë. Vlerësimi përfundimtar në vitin 2029 do të analizojë ndikimin e përgjithshëm të strategjisë, do të vlerësojë arritjen e rezultateve të synuara dhe do të japë rekomandime konkrete për periudhat pasuese.

Monitorimi i vazhdueshëm do të kontribuojë në optimizimin e politikave, identifikimin e pengesave, përmirësimin e efikasitetit të investimeve dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e zhvillimit ekonomik lokal. Kjo qasje gjithëpërfshirëse synon të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm, përmirësim progresiv dhe të krijojë një bazë të fortë për rritjen ekonomike të komunës, duke nxitur investime, rritje të punësimit dhe përmirësim të mirëqenies së qytetarëve.

8. NDIKIMI BUXHETOR

BUXHETI KOMUNAL – Korniza Afatmesme Buxhetore e komunës së Kaçanikut është një dokument kyç me rëndësi të lartë strategjike për nivelin komunal. Ajo paraqet objektivat kryesore për të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore, të strukturuar sipas kategorive ekonomike, duke reflektuar vizionin zhvillimor të komunës. Përveç kësaj, KAB luan rol strategjik në procesin e planifikimit të buxhetit, duke e lidhur alokimin e burimeve me prioritetet komunale dhe duke siguruar vazhdimësinë e zbatimit të programeve gjatë periudhës trevjeçare që pason.

Komunat përballen me një pabarazi të theksuar në aspektin financiar, pasi vetëm 18% e të hyrave të tyre burojnë nga burime vetanake, ndërsa pjesa dërrmuese prej 82% mbështetet në grantin qendror të ndarë nga Buxheti i Kosovës. Kjo varësi e lartë ndaj financimit qeveritar kufizon ndjeshëm aftësinë e komunave për të ushtruar autonomi në investime dhe për të realizuar projekte zhvillimore në përputhje me nevojat lokale.³²

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Kaçanikut për vitin 2025 është 12,592,239€, i mbështetur nga dy burime kryesore: grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Nga kjo shumë, 11,641,838€ (92.45%) sigurohen nga granti qeveritar, ndërsa 950,401€ (7.55%) planifikohen të gjenerohen përmes të hyrave që gjeneron vetë komuna.

Pjesa dërrmuese e buxhetit total të komunës së Kaçanikut vazhdon të mbështetet nga transferet qeveritare, duke reflektuar varësinë e lartë ndaj financimit qendror. Ky trend pritet të vazhdojë edhe gjatë periudhës 2026-2028. Për një pasqyrë më të detajuar, shihni tabelën dhe grafikun e mëposhtëm që paraqesin strukturën e burimeve buxhetore.

Burimet e financimit. Burimet kryesore të financimit për komunën e Kaçanikut përfshijnë të hyrat vetanake, grantet qeveritare, mbështetjen nga donatorët e jashtëm dhe huamarrjen komunale. Këto komponentë formojnë themelin e buxhetit komunal, duke mundësuar realizimin e shërbimeve publike dhe projekteve zhvillimore.

Të hyrat vetanake përbëhen nga mjetet financiare që komuna mbledh përmes taksave lokale, tarifave për shërbime, gjobave, pagesave për shërbimet publike, qirave nga pronat komunale, të ardhurave nga shitja e pasurive të paluajtshme, kontributeve të ndërmarrjeve komunale dhe bashkëpagesave në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë.³³



Komunat gjithashtu përfitojnë nga grantet operative të ndara nga Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës. Këto përfshijnë grantin e përgjithshëm, si dhe grantet specifike për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë. Gjatë vitit 2025, Komuna e Kaçanikut ka përfituar një total prej 11,641,838€ në formë grantesh qeveritare. Prej kësaj shume, 5,538,386€ (47.6%) janë

³² Strategjinë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 23.

³³ Ligji nr. 03/I-049 për financat e pushtetit lokal.


ndarë si grant i përgjithshëm, 4,626,225€ (39.7%) grant për arsimin, ndërsa 1,477,227€ (12.69%) grant për sektorin e shëndetësisë.

Tab. 10 Burimet e financimit në komunën e Kaçanikut (€), periudha 2026-2028

BURIMI I TË HYRAVE	2025	Planifikimi 2026	Vlerësimi 2027	Vlerësimi 2028
Granti i përgjithshëm	5,538,386	5,886,269	6,286,568	6,769,239
Granti i arsimit	4,626,225	4,761,842	4,904,697	5,051,838
Granti i shëndetësisë	1,477,227	1,686,509	1,737,104	1,789,218
Gjithsej granti qeveritar	11,641,838	12,334,620	12,928,369	13,610,295
Të hyrat vetanake	950,401	1,065,133	1,142,071	1,146,763
GJITHSEJ BUXHETI	12,592,239	13,399,753	14,070,440	14,757,058

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Kaçanikut 2026-2028.

Graf. 16 Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Kaçanikut (%), periudha 2025-2028



Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, është realizuar një analizë e mesatares së grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake për periudhën 2025–2028. Rezultatet e kalkulimit tregojnë se komuna e Kaçanikut mbështetet kryesisht nga financimi qendror, ku rreth 92% e buxhetit vjetor përfitohet nga grantet qeveritare, ndërsa vetëm rreth 8% e buxhetit mbulohet nga të hyrat vetanake. Kjo përbërje financiare pasqyron një nivel të lartë varësie ndaj granteve dhe një nevojë të vazhdueshme për fuqizimin e kapaciteteve lokale në gjenerimin e të ardhurave.

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Kaçanikut 2026-2028.

Tab. 11 Planifikimi i të hyrave vetanake në komunën e Kaçanikut (€), 2026-2028

STRUKTURA E TË HYRAVE VETANAKE	2026	2027	2028
Tatimi në pronë	384,577	412,458	421,582
Tatimi në tokë	93,925	113,649	119,218
Licencat dhe lejet	20,000	20,000	21,000
Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	24,000	24,000	23,000
Taksat e pajisjeve motorike	71,000	71,000	72,000
Lejet për ndërtesa	309,631	332,964	317,963
Taksat tjera komunale	32,000	35,000	35,000
Taksat për mbeturinat	-	-	-
Ngarkesat rregullatore	10,000	10,000	10,000
Të hyrat nga qiraja	15,000	17,000	17,000
Bashkë-pagesat për arsim	40,000	40,000	43,000
Bashkë-pagesat për shëndetësi	5,000	6,000	7,000
Ngarkesat tjera komunale	50,000	50,000	50,000
Të hyrat tjera	10,000	10,000	10,000
GJITHSEJ	1,065,133	1,142,071	1,146,763

Burimi: Të dhëna nga komuna e Kaçanikut.

Në tabelën e mësipërme është prezantuar struktura e parashikuar e të hyrave vetanake të komunës së Kaçanikut për periudhën 2026-2028. Siç vërehet, baza kryesore e këtyre të hyrave përbëhet nga taksat dhe tatimet lokale. Tatimi në pronë pritet të kontribuojë me rreth 36% të totalit, duke dëshmuar rolin e tij të rëndësishëm në të hyrat financiare të komunës. Ndërkohë, afërsisht 28% e të hyrave janë planifikuar të vijnë nga taksa komunale për leje ndërtimi. Pjesa tjetër, që përfaqëson rreth 36% të të hyrave vetanake, buron nga kategori të ndryshme si tatimi në pronë, të hyrat nga gjobat në trafik, tarifat për shërbime komunale dhe të ardhura nga sektorë të tjerë, të cilat, ndonëse më modeste, ofrojnë një kontribut të qëndrueshëm në buxhetin komunal.


Struktura e shpenzimeve: Siç paraqitet në tabelën në vijim, shpenzimet rrjedhëse zënë pjesën më të madhe të buxhetit komunal, me një mesatare prej 75.5%, ndërsa investimet kapitale përfaqësojnë 24.5% të totalit të shpenzimeve. Brenda shpenzimeve rrjedhëse, pjesa më e madhe e fondeve është e orientuar drejt kompensimit për punonjësit përmes pagave dhe mëditjeve. Pas tyre, vijojnë shpenzimet për mallra dhe shërbime, mbështetja përmes subvencioneve dhe shpenzimet që lidhen me funksionimin e rregullt të komunës.

Tab. 12 Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Kaçanikut (€), vlerësim për periudhën 2026-2028

STRUKTURA E SHPENZIMEVE BUXHETORE	2026	%	2027	%	2028	%
Pagat dhe mëditjet	7,883,305	77.3	7,922,722	75.1	7,962,335	71.8
Mallrat dhe shërbimet	1,469,980	14.5	1,669,980	15.9	2,199,980	19.8
Subvencionet	614,157	6.0	676,544	6.4	608,348	5.5
Shpenzime komunale	225,000	2.2	275,000	2.6	325,000	2.9
<i>Gjithsej shpenzime rrjedhëse</i>	<i>10,192,442</i>	<i>100.0</i>	<i>10,544,246</i>	<i>100.0</i>	<i>11,095,663</i>	<i>100.0</i>
Shpenzimet rrjedhëse	10,192,442	76.1	10,544,246	75.2	11,095,663	75.2
Investime kapitale	3,207,311	23.9	3,476,194	24.8	3,661,395	24.8
GJITHSEJ	13,399,753	100.0	14,020,440	100.0	14,757,058	100.0

Burimi: Të dhëna nga komuna e Kaçanikut.

Graf. 17 Struktura mesatare e shpenzimeve në komunën e Kaçanikut (%), vlerësim për periudhën 2026-2028



Burimi: Të dhëna nga komuna e Kaçanikut.

VLERËSIMI BUXHETOR – Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve: Plani i veprimit për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të komunës së Kaçanikut për periudhën 2026-2030 parashikon një kosto totale të zbatimit prej 9,693,500€. Ky buxhet mbulon investime në projekte kapitale, subvencione për sektorin privat, si dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale, me synim nxitjen e qëndrueshme të ekonomisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë.

Burimet e financimit të strategjisë: Vlerësimi buxhetor i strategjisë është strukturuar sipas kategorive specifike të ndërhyrjes, ku një pjesë e financimit mbështetet nga buxheti komunal, ndërsa pjesa tjetër pritët të sigurohet përmes granteve qeveritare, donatorëve ndërkombëtarë dhe investimeve nga sektori privat. Zbatimi i planit do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes indikatorëve ekonomikë dhe socialë, duke garantuar transparencë në procesin e alokimit të fondeve dhe efektivitet në realizimin e objektivave strategjike.

SHTOJCA 1

Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SZHEL

Qëllimi strategjik #1: Nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm lokal

Objektivi specifik 1.1	Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2026	Caku 2027
	- Numri i zonave me infrastrukturë të përfunduar - Modeli i menaxhimit i implementuar - Numri i vizitorëve dhe kontakteve nga platforma digjitale - Numri i pjesëmarrësve dhe marrëveshjeve në panairin ekonomik - Numri i bizneseve të reja të vendosura në zonat ekonomike			15%	60%	100%
	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Funksionalizimi i zonave ekonomike dhe industriale	1.1.1 Përfundimi i infrastrukturës fizike në zonat ekonomike	2026-2027	200,000€	Komuna e Kaçanikut në bashkëpunim me sektorin publiko-privat si dhe me OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare	Komuna e Kaçanikut	Komuna e Kaçanikut, ministritë relevante, OJQ
			2026: 100,000€			
			2027: 100,000€			
	1.1.2 Modeli i menaxhimit të qëndrueshëm për zonat industriale	2026-2027	20,000€	Komuna e Kaçanikut, donatorët, OJQ	Komuna e Kaçanikut	Komuna e Kaçanikut, donatorët, ministritë relevante, OJQ
			2026: 10,000€			
			2027: 10,000€			
	1.1.3 Platforma digjitale për promovimin e zonave ekonomike	2026-2027	15,000€	Komuna e Kaçanikut, donatorët, ministritë relevante, OJQ	Komuna e Kaçanikut	Komuna e Kaçanikut, donatorët, ministritë relevante, OJQ
			2026: 10,000€			
			2027: 5,000€			
	1.1.4 Panairi Ekonomik i Kaçanikut	2026-2027	100,000€			

SHTOJCA 1

Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

			2026: 50,000€	Komuna e Kaçanikut, bizneset, donatorët	Komuna e Kaçanikut	Komuna e Kaçanikut, ministritë relevante, donatorët
			2027: 50,000€			
	1.1.5 Programi për mbështetje të investitorëve të rinj	2026-2027	50,000€	Komuna e Kaçanikut, OJQ	Komuna e Kaçanikut	Komuna e Kaçanikut, OJQ
			2026: 25,000€			
			2027: 25,000€			
	1.1.6 Skema e garancisë komunale për bizneset e vogla	2026	50,000€	Komuna e Kaçanikut në bashkëpunim me MFPT, donatorë dhe institucione financiare lokale	Komuna e Kaçanikut	MFPT, OJQ-të lokale, banka partnere, MAPL
Objektivi specifik 1.2	Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2026	Caku 2027
	- Koha mesatare për regjistrimin e biznesit - Numri i bizneseve të subvencionuara - Numri i bizneseve të promovuara - Numri i bizneseve të reja të regjistruara			15%	65%	100%
